

Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) në Kosovë
UDHËZUESI I PËRDORUESIT PËR MODELIN E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE
PËR PERIUdhËN 2026-2028
Qershor 2025

Ky Udhëzues i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave është përgatitur për procesin e përcaktimit të tarifave për periudhën 2026-2028 dhe zëvendëson udhëzuesit paraprak të përdoruesit për modelin e përcaktimit të tarifave. Ky udhëzues do të mbetet në fuqi për përcaktimet e ardhshme të tarifave, me përjashtim të rasteve kur kërkohen ndryshime nga ARRU

Misioni

“Shërbime cilësore, të sigurt dhe efçiente të shërbimeve të ujit për të gjithë konsumatorët në Kosovë.”

Vizioni

“Rregullimi i sektori i ujit në mënyrë transparente dhe të paanshme, në përputhje me praktikat e mira evropiane, që siguron që ndërmarrjet e ujësjellësit të ofrojnë një shërbim cilësor, të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të përballueshëm në tërë territorin e Kosovës, duke respektuar si mjedisin ashtu edhe shëndetin publik.”

Përmbajtja

Preambula1

Dokumentet shoqërues të rëndësishëm2

Përkufizimet dhe akronimet3

1 Historiku, procesi dhe korniza e përgjithshme4

1.1 Ndryshimet kryesore në modelin dhe udhëzuesin e zhvilluar për përcaktimin e tarifave për periudhën 2012-2014 4

2 Struktura dhe veçoritë e modelit të përcaktimit të tarifave5

2.1 Platforma e modelit për përcaktimin e tarifave 5

2.2 Fletët e punës5

2.3 Mbrojtja 5

2.4 Koncepti i përgjithshëm i përcaktimit të tarifave 5

2.5 Qelizat për të dhëna hyrëse dhe për llogaritje 5

2.6 Shqyrtimi i parashtrësave nga ARRU dhe procesi i pasqyrimimit 6

2.7 Shënimet udhëzuese brenda fletëve të punës 6

2.8 Gjuha 6

2.9 Referencat dhe navigimi 6

2.10 Referencat në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) 6

3 Fletët e punës për të dhënat hyrëse7

4	Fletët e punës për llogaritje	42
5	Fletët e punës për rezultate	61

Kontrolli i ndryshimeve

Versioni i rishikimit	Miratuar	Detajet e ndryshimeve
01	ZRRUM 25/05/2011	Veroni i parë për KRU-të
02	ZRRUM 13/06/2011	Ndryshimet në emrin e skedarit (seksioni 1.2) Ndryshimet në seksionin e modelit 1.1.1 (indekset e inflacionit)
03	ARRU 06/05/2025	Rishikimi i thellë i modelit të përcaktimit të tarifave pas konsultimeve të janarit të vitit 2024 dhe vendimeve të ARRU-së të janarit 2025.
04	ARRU 11 /5/ 2025	Përfshirja e referencës për fletët e llogaritjes.
05	ARRU 11 /6/ 2025	Përfshirja e veçorive të rikthimit në udhëzime
06	ARRU 16/6/2025	Përfshirja e faktorit të sjelljes për reduktimin e humbjeve të dukshme.

Preambula

Ky Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave është përgatitur për të ndihmuar kompanitë rajonale të ujësjellësit (KRU-të) dhe zyrtarët e ARRU-së në përdorimin e modelit të përcaktimit të tarifave për Rishikimin e Tarifave për periudhën 2026–2028. Këto shënime ofrojnë udhëzime dhe instruksione për plotësimin e modelit me të dhënat e nevojshme hyrëse. Këto shënime udhëzuese duhet të lexohen në lidhje me dokumentacionin tjetër mbështetës, përfshirë: *Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR)*, *Procedurat për Përcaktimin e Tarifave*, *Udhëzimet për tarifat për përforcimin e infrastrukturës*, dhe *Marrëveshjet për tarifat për cilësinë e ujërave të ndotura*, të publikuara nga ARRU.

Modeli i përcaktimit të tarifave ka pësuar një rishikim të konsiderueshëm pas konsultimit të mbajtur në janar të vitit 2024 dhe vendimeve përkatëse të ARRU-së në janar 2025. Këto përfshijnë:

- Heqjen e përsheptuar të ndër-subvencioneve.
- Prezantimin e tarifave fikse bazuar në madhësitë e ujëmatësve.
- Prezantimin e tarifave për përmirësimin e infrastrukturës .
- Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura të vlerësuara kur gjenerimi i ujërave të ndotura nuk lidhet me konsumimin e ujit nga KRU.
- Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura për të pasqyruar cilësinë e ujërave të ndotura për konsumatorë të veçantë jo-shtëpiak.
- Tarifat duhet të pasqyrojnë pritshmëritë e arsyeshme, për reduktimin e humbjeve të dukshme.
- Tarifat duhet të pasqyrojnë kompensimin për konsumatorët për investime të përfshira në rishikimet e mëparshme tarifore, por që nuk janë realizuar.

Modeli gjithashtu përfshin ndryshime për të përmirësuar lehtësinë e përdorimit pas komenteve të pranuar nga KRU-të. Një ndryshim madhor në këtë drejtim është që modeli tani përbëhet nga një dokument i vetëm në Excel në vend të dy dokumenteve, si në modelin paraprak.

Ky udhëzues është përgatitur për të ndihmuar KRU-të në plotësimin e modelit me të dhënat e sakta hyrëse. Nëse kërkohet shpjegim, udhëzim apo ndihmë shtesë, përdoruesi duhet të kontaktojë ARRU-në. Nëse është e nevojshme, mund të bëhen herë pas here rishikime të këtyre shënimeve udhëzuese. Për më tepër, nëse përdoruesit e modelit identifikojnë ndonjë gabim apo mangësi tjetër, duhet ta njoftojnë ARRU-në pa vonesë.

Ky udhëzues i rishikuar i përdoruesit, zbatohet për modelin e përgatitur për periudhën e ardhshme të rishikimit të tarifave 2026-2028 dhe më tej, me kusht që t'i nënshtrohet ndryshimeve të mëtejshme sipas nevojës.

Dokumentet shoqërues të rëndësishëm

Këto *Procedura të Tarifave* duhet të lexohen së bashku me dokumentet e mëposhtme:

- Ligji Nr. 05/L-042 për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit (i ndryshuar)
- Politika e Rishikuar e Tarifave të ARRU-së (prill 2025)
- Procedurat për Përcaktimin e Tarifave të ARRU-së (prill 2025)
- Rregullorja e ARRU-së për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimeve për Ujin, Ujërat e Zeza dhe Furnizimin me Ujë në Kosovë (2012, i ndryshuar) [që do të ndryshohet për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028]
- Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR) (V02 2011) [do të ndryshohen për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028]
- Konsultimi i ARRU-së mbi 'Politikën e ardhshme tarifore', për furnizimin me ujë, janar 2024
- Raporti i ARRU-së për përgjigjet ndaj konsultimit, mbi 'Politikën e ardhshme të tarifave për furnizimin me ujë', prill 2024

Ky model i rishikuar dhe udhëzuesi i përdoruesit, është zhvilluar për të mbështetur vendimet e fundit rregullatore që u janë komunikuar KRU-ve nëpërmjet letrave të dërguara në dhjetor të vitit 2024, pas konsultimit lidhur me:

- Përmirësimin e informacionit të planifikimit afarist të bazuar në prova të verifikueshme
- Tarifat fikse bazuar në madhësinë e kycjes
- Tarifat për ujërat e ndotura industriale dhe udhëzimet shoqëruese
- Humbjet e ujit që do të merren parasysh në përcaktimin e tarifave të ardhshme.
- Kthimin nga Baza Rregullatore e Aseteve (BRRA)
- Tarifat e vlerësuara të ujit
- Heqjen e ndër-subvencionimit.
- Rimbursimin e parave të paguara nga konsumatorët për investimet që nuk janë realizuar.
- Tarifat për përforcimin e rrjetit dhe udhëzimet shoqëruese

Përkufizimet dhe akronimet

Humbjet e dukshme: Konsumimi që nuk regjistrohet, për shkak të gabimeve në ujëmatës dhe konsumatorëve të paregjistruar.

Mirëmbajtja kapitale: Puna e planifikuar e realizuar nga Kompanitë Rajonale të Ujësjellësit, për të zëvendësuar dhe riparuar asetet e furnizimit me ujë dhe shërbimet e ujërave të ndotura për të siguruar një shërbim bazë për konsumatorët.

Kompensimi: procesi përmes të cilit bëhen rregullime në kërkesën për të ardhura për të kompensuar konsumatorët për investimet që janë përfshirë në rishikimet e mëparshme të tarifave, por që nuk janë realizuar.

Tarifat për kyçje: Tarifa për konsumatorin ose zhvilluesin e projektit ndërtimor, për të mbuluar kostot e kyçjes në rrjetin kryesor të konsumatorëve.

Indeksi i çmimeve të konsumit (CPI): Indeksi për matjen e inflacionit të konsumatorëve, i publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Ndër-subvencionimi: Një rregullim çmimesh ku një ose më shumë grupe të konsumatorëve, paguajnë një çmim më të lartë, për shërbimet e tyre, për të subvencionuar çmimet për një ose më shumë grupe të tjera të konsumatorëve.

Kontabiliteti i kostos aktuale: Një metodë e kontabilitetit, që paraqet transaksionet dhe raporton vlerat e tyre aktuale. Në vend që të shfaqen asetet sipas kostos së tyre historike (p.sh. çmimi i blerjes fillestare), minus amortizimi ku është e përshtatshme, asetet shfaqen sipas kostos së tyre aktuale (kostoja e zëvendësimit), në momentin e krijimit të llogarive. Kjo metodë e kontabilitetit përdoret në industrinë e ujit për shkak të natyrës së gjerë të aseteve kapitale dhe faktit që kostot historike nuk pasqyrojnë vlerën e vërtetë të aseteve.

Zhvlërimi i kostos aktuale: Zhvlërimi i llogarit, në përputhje me metodat e kontabilitetit të kostos aktuale.

Përmirësimi: Përmirësimi dhe zgjerimi i bazës së aseteve përmes nivelit të përmirësuar të shërbimeve dhe/ose zgjerimit të sistemit.

Tarifat fikse: Komponenti i strukturës tarifore, që është një shumë fikse për muaj, pavarësisht nga vëllimi i ujit të konsumuar ose ujërave të ndotura të shkarkuara.

Grantet: Financimi i ofruar për investime ose ofrimin e shërbimeve, për të cilat nuk kërkohet kthim. Investimi në infrastrukturë i financuar nga grantet nuk i shtohet as tarifës së rinovimit të infrastrukturës dhe as bazës rregullatore të aseteve.

Asetet infrastrukturore: Asetet (kryesisht asetet nëntokësore), që nuk kanë një jetëgjatësi të kufizuar dhe të cilat, nëse mirëmbahen siç duhet, do të jenë në gjendje të vazhdojnë të ofrojnë një nivel të paracaktuar shërbimi për konsumatorët për një kohë të pacaktuar.

Tarifa për rinovimin e infrastrukturës: Një dispozitë vjetore kontabël për shpenzimet për rinovimin e aseteve infrastrukturore (d.m.th. kryesisht nëntokësore) që ngarkohet në llogarinë e fitimit dhe humbjes rregullatore.

Asetet jo infrastrukturore: Kryesisht asetet sipërfaqësore siç janë punishtet e trajtimit të ujit, stacionet e pompimit dhe laboratorët e kompanisë, depot dhe punëtoritë.

Tarifat për përforcimin e infrastrukturës: Tarifat për zhvilluesit e projekteve ndërtimore për të mbuluar kostot kumulative të përmirësimit të rrjetit të shkaktuar nga pronat e reja.

Shpenzimet operative: Shpenzimet e drejtpërdrejta operative lidhur me ofrimin e shërbimit, duke përfshirë fuqinë punëtore; energjinë; kimikatet; materialet shpenzuese; shpenzimet e përgjithshme; taksat e paktyeshme dhe shpenzimet tjera të përsëritura.

Periudha e kontrollit të çmimeve: Periudha (zakonisht tri vjeçare) gjatë së cilës do të zbatohet rishikimi i tarifave.

Humbjet reale: Humbjet e ujit në rrjet i atribuohen rrjedhjeve fizike në tubacione.

Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKR): Rregullat e kontabilitetit të përcaktuara nga ARRU për regjistrimin e transaksioneve financiare në atë mënyrë që është në përputhje me procedurat dhe modelin e përcaktimit të tarifave.

Baza rregullatore e aseteve (BRR): Baza e kapitale që përdoret për përcaktimin e kufijve të çmimeve. Përfaqëson vlerën fillestare të investimeve të bëra dhe borxhit, kapitalit qarkullues, kapitalit e qeverisë dhe shpenzimet e reja kapitale neto. Vlera e bazës rregullatore të aseteve llogaritet pasi të bëhet zhvlërimi i kostos aktuale dhe rregullohet sipas inflacionit në secilën periudhë të re të rishikimit të çmimeve.

Kthimi nga BRR: Një kthim i drejtë nga baza rregullatore e aseteve, i paraqitur si të ardhura vjetore dhe rritje e kapitalit nga investimi, e shprehur si përqindje e investimit fillestar.

Kërkesa për të ardhura (KA): Të ardhurat vjetore të nevojshme, për të financuar aktivitetet e KRU-ve, duke përfshirë kthimin nga kapitali. Ajo përfshin kostot operative; tarifën për rinovimin e infrastrukturës; zhvlërimin e kostos aktuale; kthimin nga BRR dhe kostot tjera sipas rastit.

KRU: Kompania Rajonale e Ujësjellësit e rregulluar nga ARRU.

Procedurat e Përcaktimit të Tarifave: Procedura e detajuar e llogaritjes së tarifave për përcaktimin e tarifave gjatë periudhës së caktuar të kontrollit të çmimeve.

Përcaktimet e tarifave: Një proces, ku ARRU, përcakton tarifat për periudhën e specifikuar të shqyrtimit të tarifave, në përputhje me rregullat dhe procedurat e specifikuar.

Tarifat e ndryshueshme: Komponenti i strukturës tarifore, që bazohet në një normë - për njësi për m³ ujë të konsumuar.

ARRU: Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit, rregullatori ekonomik, i emëruar për sektorin e furnizimit me ujë dhe shërbimeve të kanalizimit në Kosovë.

1 Historiku, procesi dhe korniza e përgjithshme

1.1 Ndryshimet kryesore në modelin dhe udhëzuesin e zhvilluar për përcaktimin e tarifave për periudhën 2012-2014

- 1.1 Politikat, procedurat, modeli dhe informacionet tjera mbështetëse për përcaktimin e tarifave, janë përdorur që nga rishikimi i tarifave për periudhën 2012–2014, me modifikime minimale. Megjithëse këto mjete rregullatore i kanë shërbyer mirë Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU) dhe kompanive rajonale të ujësjellësit (KRU), ARRU, ka vlerësuar se ishte i domosdoshëm një rishikim i thelluar. Ky rishikim kishte për qëllim të merrte parasysh zhvillimet e reja në sektor në Kosovë, komentet nga KRU-të dhe faktorët tjerë.
- 1.2 Në janar të vitit 2024, ARRU ka ndërmarrë një konsultim me qëllim që të marrë nga të gjithë palët e interesit mendimet e tyre lidhur me propozimin e ARRU-së për përmirësim. Këto kanë përfshirë:
- Zëvendësimin e tarifës fikse mujore me dy nivele (shtëpiake dhe jo-shtëpiake) me një tarifë fikse më reale sa i përket kostos, të bazuar në madhësinë e kçjes.
 - Përsheptimin e heqjes së ndër-subvencionimit nga konsumatorët jo-shtëpiak në favor të konsumatorëve shtëpiak.
 - Një mekanizëm përmes të cilit konsumatorët kompensohen në mënyrë efektive përmes tarifave të ardhshme për investimet e përfshira në përcaktimet e tarifave që nuk janë realizuar.
 - Masat për përmirësimin e planifikimit afarist dhe paraqitjes së dokumentacionit për përcaktimin e tarifave përmes kërkesës për dëshmi mbështetëse, veçanërisht për programin e investimeve, kryesisht për të adresuar problemin e investimeve të propozuara por të përealizuara.
 - Prezantimin e tarifave për përmirësimin e infrastrukturës për zhvilluesit, në mënyrë që të kontribuohet në financimin e përforcimit të rrjetit në rrjedhën e sipërme (ujë) dhe rrjedhën e poshtme (ujëra të ndotura), që shkaktohet nga efekti kumulativ i zhvillimeve të reja. Kjo do të rezultojë me tarifa pak më të ulëta për konsumatorët shtëpiak sesa në rastin kur ato do të ishin ndryshe.
 - Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura të vlerësuara, në rastet kur sasia e ujërave të ndotura të gjeneruara nuk reflekton sasinë e ujit të furnizuar nga KRU.
 - Prezantimin e tarifave për ujërat e ndotura të bazuara në cilësinë e tyre, në rastet kur cilësia e ujërave të ndotura është dukshëm ndryshe nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura.
- 1.3 Rezultatet e konsultimit kanë qenë kryesisht pozitive dhe shumica e propozimeve janë pranuar në metodologjinë e re për përcaktimin e tarifave. Në disa raste, veçoritë e reja janë opsionale dhe KRU-të individuale mund të kërkojnë përjashtim nga kërkesat përkatëse nëse vlerësojnë se ato nuk zbatohen për to dhe/ose përfitimet janë minimale.
- 1.4 Këto kërkesa të reja janë përshkruar në letrat që u janë dërguar KRU-ve në janar 2025, para publikimit të mjeteve të rishikuara për përcaktimin e tarifave.
- 1.5 Kërkesat tjera që nuk janë përfshirë në konsultim u janë komunikuar gjithashtu KRU-ve në janar 2025, në veçanti nevoja që KRU-të të ndërmarrin masa për kontrollin e humbjeve të tyre (të dukshme dhe reale) në nivelet e tyre ekonomikisht eficiente. Kjo përfshin edhe pritshmërinë e arsyeshme për reduktimin e humbjeve të dukshme që do të përfshihet në modelin për përcaktimin e tarifave.
- 1.6 Modeli i ri është zhvilluar për të përfshirë propozimet dhe vendimet e ARRU-së si dhe përmirësimet në lehtësinë e përdorimit. Megjithëse parimet dhe konceptet e aplikuara në procesin e përcaktimit të tarifave mbeten kryesisht të pandryshuara, struktura e modelit të ri paraqet një ndryshim rrënjësor në krahasim me versionin e mëparshëm.

2 Struktura dhe veçoritë e modelit të përcaktimit të tarifave

2.1 Platforma e modelit për përcaktimin e tarifave

- 2.1 Modeli i mëparshëm i tarifave është zëvendësuar me një model të përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme, që kap të gjitha ndryshimet që kanë rezultuar nga konsultimet dhe vendimet e mëvonshme të ARRU-së.
- 2.2 Modeli përfshin një fletë pune të vetme në MS Excel.
- 2.3 Modeli përcakton kërkesat për të dhënat hyrëse në fletët specifike të punës hyrëse, nga të cilat përcaktohen të gjitha tarifat.

2.2 Fletët e punës

- 2.4 Modeli përfshin katër kategori të fletëve të punës.
- Fletët e punës së të dhënave hyrëse janë të shënuara me skedën me ngjyrë të kaltër dhe emri i fletës së punës janë në formatin `[numri]_Input [emri]`.
 - Fletët e punës së të dhënave hyrëse vetëm për ARRU-në janë të shënuara me skedën me ngjyrë të gjelbër dhe emri i fletës së punës është në formatin `[numri]_Input [emri]ARRU adj.` KËTO FLETË TË PUNËS JANË VETËM PËR PËRDORIMIN E ARRU-së.
 - Fletët e punës për llogaritje janë të shënuara me skedë me ngjyrë kafe dhe emri i skedës është në formatin `[numri]_Calc [emri]`
 - Fletët e punës së rezultateve janë të shënuara me skedë me ngjyrë rozë dhe emri i skedës është në formatin `[numri]_output [emri]`
- 2.5 Për të përdorur modelin, përdoruesi kërkohet të japë të dhëna vetëm në fletët e punës të dedikuara për të dhëna hyrëse. Të gjitha fletët e tjera të punës janë ose për llogaritje ose për rezultate, dhe nuk kërkojnë të dhëna nga përdoruesi.

2.3 Mbrojtja

- 2.6 Të gjitha fletët e punës, përveç atyre hyrëse, janë të mbrojtura plotësisht për të parandaluar që përdoruesi të dëmtojë pa dashje integritetin e modelit.
- 2.7 Fletët e të dhënave hyrëse janë të mbrojtura pjesërisht dhe ia mundësojnë përdoruesit të fusë të dhëna vetëm në qelizat e dedikuara për të dhëna hyrëse.
- 2.8 Mbrojtja sigurohet me fjalëkalim dhe fjalëkalimet mbahen nga ARRU.
- 2.9 Nëse një parashtrësë përfshin një model që identifikohet si i korruptuar në çfarëdo mënyre, qoftë qëllimisht apo pa dashje, ai do t'i kthehet KRU-së me një model të ri bosh dhe të mbrojtur me fjalëkalim për t'u plotësuar sërish dhe për t'u dorëzuar përsëri në ARRU.

2.4 Koncepti i përgjithshëm i përcaktimit të tarifave

- 2.10 Dokumenti *'Procedurat për Përcaktimin e Tarifave të ARRU-së' (prill 2025)* ofron një përmbledhje të plotë të metodologjisë së përcaktimit të tarifave. Përdoruesit e modelit duhet të njihen mirë me këtë dokument.
- 2.11 Ky udhëzues i përdoruesit ofron informacione më të detajuara, shpjegime dhe sqarime që lidhen me zërat e veçantë të modelit për të orientuar procesin e futjes së të dhënave.
- 2.12 Gjithashtu, udhëzuesi përmban shënime shpjeguese për fletët e punës për llogaritje, por nuk hyn në detaje në lidhje me algoritmet matematikore brenda tyre.

2.5 Qelizat për të dhëna hyrëse dhe për llogaritje

- 2.13 Fletët e punës për të dhënat hyrëse përfshijnë qeliza (me ngjyrë të kaltër), të cilat tregojnë ku kërkohet të futen të dhënat. Nëse ndonjë e dhënë nuk kërkohet, përdoruesi duhet ta lërë atë bosh atë qelizë.

2.14 Të gjitha qelizat e llogaritjes dhe të rezultateve janë me ngjyrë kafe.

2.6 Shqyrtimi i parashtrësive nga ARRU dhe procesi i pasqyrimit

- 2.15 Modeli përfshin një funksionalitet të pasqyrimit të parashtrësive të të dhënave dhe të llogaritjeve për përcaktimin e tarifave në çdo fletë (përveç planit të menaxhimit të asetëve (PMA), ku përdoren fletët e punës identike për ARRU-në, për të ndryshuar PMA-në). Ky pasqyrim përfshin një sërë qelizash të të dhënave hyrëse, llogaritëse dhe dalëse që dyfishon procesin e llogaritjes. Qëllimi i këtij funksioni është t'ia mundësojë ARRU-së të fusë të dhëna, që ndryshojnë nga ato të paraqitura nga KRU nëse ARRU konsideron se të dhënat janë të pasakta, bazuar në një objektivi që besohet të mos jetë mjaft sfidues ose bazohet në të dhëna që nuk kanë prova të mjaftueshme për t'u marrë në konsideratë (pjesërisht ose plotësisht). Këto qeliza janë me ngjyrë të gjelbër kur vlerat e futura janë të njëjta me ato të dorëzuara.
- 2.16 Komponenti i pasqyruar bazë i modelit në ARRU parazgjedh të dhënat hyrëse nga KRU. Nëse ARRU vlerëson se ndonjë e dhënë hyrëse duhet të ndryshohet, dhe më pas bëhet ndryshimi, qelizat e ndryshuara shënohen me ngjyrë të kuqe. Kjo bëhet për të mundësuar që si ARRU ashtu edhe KRU të shohin qartë se ku janë bërë ndryshimet.
- 2.17 Pasi një qelizë e pasqyruar të jetë ndryshuar, çdo qelizë tjetër llogaritëse apo rezultuese që ndikohet nga ky ndryshim do të shënohet gjithashtu me ngjyrë të kuqe, pavarësisht nga shkalla e ndryshimit.
- 2.18 Ky proces i pasqyrimit ia mundëson përdoruesit të shohë jo vetëm ndryshimet e bëra, por edhe ndikimin e menjëhershëm të tyre në procesin e llogaritjes dhe rezultatet e tarifave.
- 2.19 Përdorimi i këtij procesi të pasqyrimit është ekskluzivisht për ARRU-në dhe KRU-ve u kërkohet të mos fusin të dhëna në qelizat e pasqyruara.
- 2.20 Vetëm për ARRU-në. Nëse gjatë përdorimit të funksionit të pasqyrimit, përdoruesi i ARRU-së dëshiron të anulojë një të dhënë të futur dhe të rikthehet në të dhënat e dorëzuara nga KRU, atëherë qeliza përkatëse duhet të lidhet me qelizën hyrëse të KRU-së duke përdorur funksionin [= (referenca e qelizës)].

2.7 Shënimet udhëzuese brenda fletëve të punës

2.21 Fletët individuale të punës ofrojnë një seksion udhëzues specifik për atë fletë pune. Ky udhëzues i përdoruesit e përsërit këtë udhëzim dhe/ose e shton atë.

2.8 Gjuha

2.22 Përshkrimet e qelulave në Excel janë dhënë në gjuhën shqipe dhe angleze.

2.9 Referencat dhe navigimi

- 2.23 Fletët e punës së të dhënave përmbajnë një sistem numerik me shumë nivele, i cili përdoret si referencë për këtë udhëzues.
- 2.24 Për të lehtësuar navigimin mes fletëve të punës, çdo fletë ka një lidhje me fletën e punës [00_notes], ku ofrohet një listë me lidhje me të gjitha fletët tjera të punës.

2.10 Referencat në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR)

2.25 Ky udhëzues përfshin një dispozitë për referencat në Udhëzimet e Kontabilitetit Rregullator (UKRR), kur është e nevojshme. UKRR do t'i nënshtrohen një rishikimi të thellë gjatë vitit 2025 dhe për këtë arsye këto referenca do të mbeten bosh derisa të zhvillohen UKRR-të e reja.

3 Fletët e punës për të dhënat hyrëse

- 3.1 Tabelat e mëposhtme ofrojnë udhëzime për të dhënat e nevojshme për të përdorur modelin e përcaktimit të tarifave. Të gjitha linjat hyrëse shënohen si ngjyrë të kaltër. Linjat e llogaritjes shënohen me ngjyrë kafe.
- 3.2 Tabelat përfshijnë një referencë për udhëzimet e kontabilitetit rregulator (UKRR). Këto referenca do të përfshihen në versionet e ardhshme të këtyre udhëzimeve pasi UKRR të rishikohet për të përbushur nevojat e kornizës së re të përcaktimit të tarifave.

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
0	Shënimet dhe kontrolli i versionit			
	Emri i KRU-së			
	Kompania e ujësjellësit ABC	Teksti	Vendosni emrin e KRU-së këtu	
	Kontrolli i versionit	Teksti	Të plotësohet nga ARRU kur nxjerrin versionet e reja të modelit/	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
1	Të dhënat ekonomike		Kjo fletë ofron të dhënat hyrëse për kriteret kryesore ekonomike të aplikuar.	
1.1	Viti bazë dhe periudha e rishikimit			
1.1.1	Viti bazë i çmimit për rishikimin e tarifave	Viti	Ky është viti që i paraprin vitit të parë të rishikimit të tarifave. Për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028, viti bazë do të jetë 2025. KRU-të do t'i fusin të gjitha kostot dhe shpenzimet në model në nivelin e çmimeve të këtij viti, d.m.th. KRU-të nuk do të bëjnë korrigeime për inflacionin e pritur.	
1.1.2	Viti i fillimit të periudhës së rishikimit të tarifave	Viti	Ky është viti i parë në të cilin do të hyjnë në fuqi tarifat e reja.	
1.1.3	Viti i përfundimit të periudhës së rishikimit të tarifave	Viti	Ky është viti i fundit në të cilin do të jenë në fuqi tarifat e reja.	
1.2	Indekset e inflacionit (qershor)			
1.2.1	2021	Indeksi	Këto janë indekset e inflacionit të muajit qershor, siç publikohen nga Agjencia e Statistikave të Kosovës për IÇK-në e përgjithshme. Asnjë devijim nga statistikat e publikuara nuk do të bëhet nga KRU-të. Këto indekse do të futen në model sapo të jenë të disponueshme të dhënat, në mënyrë që modeli të mund të përcaktojë tarifat nominale që do të zbatohen. Për shembull, duke futur indeksin e qershorit për vitin 2025, përcaktohen tarifat nominale për qershorin e vitit 2026. Pasi të jetë i disponueshëm indeksi i qershorit të vitit 2026, modeli mund të përcaktojë tarifat nominale për vitin 2027, e kështu me radhë.	
1.2.2	2022	Indeksi		
1.2.3	2023	Indeksi		
1.2.4	2024	Indeksi		
1.2.5	2025	Indeksi		
1.2.6	2026	Indeksi		
1.2.5	2027	Indeksi		
1.3	Kthimi mbi bazën rregullatore të asetëve (reale para tatimit)			
1.3.1	2022-2024	%	Ky është kthimi real nga BRRA i aplikuar në përcaktimet e mëparshme të tarifave. Këto vlera përcaktohen nga ARRU. Asnjë devijim nga vlera e përcaktuar nga ARRU nuk do të bëhet nga KRU-të.	
1.3.2	2025	%		
1.3.3	2026-2028	%	Ky është kthimi real nga BRRA i aplikuar në përcaktimin e tarifave aktuale. Kjo vlerë përcaktohet nga ARRU. Asnjë devijim nga vlera e përcaktuar nga ARRU nuk do të bëhet nga KRU-të.	
1.4	Zhvlerësimi			
1.4.1	Norma e zhvlerësimit të aplikuar për asetet jo infrastrukturorë	Vitet	Këto janë vlerat e zhvlerësimit që do të aplikohen për asetet jo infrastrukturorë. Kjo është përcaktuar nga analiza e asetëve e vitit 2008 në 35 vite. Përveç nëse KRU-të mund të demonstrojnë një ndryshim në këtë vlerë, kjo vlerë do të mbetet e pandryshuar.	
1.5	Faktori i ndër-subvencionimit dhe shitjet e ujit me shumicë			

Udhëzuesi i përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
1.5.1	Faktori i ndër-subvencionimit të furnizimit me ujë	Faktori	Këta janë faktorët vjetorë të rregullimit që aplikohen për tarifën për alokimin e një ndër-subvencioni nga konsumatorët jo-shtëpiak tek konsumatorët shtëpiak, d.m.th. një faktor prej 1.2 do të thotë se tarifa për konsumatorët jo-shtëpiak do të jetë 1.2 herë më e lartë se tarifa për konsumatorët shtëpiak. Pas vendimit të ARRU-së në dhjetor të vitit 2024, ky faktor do të jetë subjekt i vlerësimit të mëtejshëm nga ARRU..	
1.5.2	Faktori i ndër-subvencionimit të shërbimit të ujërave të ndotura	Faktori		
1.5.3	Tarifa e ujit me shumicë si përqindje e tarifës për konsumatorët shtëpiak	Faktori	Kur uji me shumicë i ofrohet KRU-ve tjera ose ofruesve të shërbimeve, tarifa me shumicë duhet të jetë më e ulët se tarifa e plotë. Ky faktor paraqet raportin ndërmjet tarifës me shumicë dhe tarifës për konsumatorët shtëpiak. Nëse një tarifë me shumicë është përcaktuar tashmë, atëherë përdoruesi duhet ta ndryshojë këtë faktor për të arritur tarifën e dëshiruar, p.sh. duke përdorur funksionin 'goalseek' në MS Excel.	
1.6	Politikat		Shënim, këto shënime (Po ose Jo) duhet të futen në gjuhën angleze (jo shqipe).	
1.6.1	Konsumatorët pa ujëmatës që janë subjekt i tarifave volumetrike	Po/Jo	Statusi i konsumatorëve pa ujëmatës dhe mënyra e faturimit të tyre është aktualisht çështje për t'u debatuar. Kjo veçori ia mundëson përdoruesit të përcaktojë tarifën mbi bazën se këta konsumatorë janë ose nuk janë subjekt i tarifave sipas vëllimit.	
1.6.2	Konsumatorët pa ujëmatës që janë subjekt i tarifave fikse	Po/Jo	Kjo veçori ia mundëson përdoruesit të përcaktojë tarifën mbi bazën se këta konsumatorë janë ose nuk janë subjekt i tarifave fikse.	
1.6.3	Tarifat për cilësinë e ujërave të ndotura të aplikueshme T1	Po/Jo	Kur KRU aplikon tarifa për cilësinë e ujërave të ndotura specifike për vendin (Niveli 1), përzgjedhja duhet të jetë "Po". Nëse KRU ka marrë një përzgjedhje nga aplikimi i këtyre tarifave, përzgjedhja duhet të jetë "Jo".	
1.6.4	Tarifat për cilësinë e ujërave të ndotura të aplikueshme T2	Po/Jo	Kur KRU aplikon tarifa për cilësinë e ujërave të ndotura specifike për vendin (Niveli 2), përzgjedhja duhet të jetë "Po". Nëse KRU ka marrë një përzgjedhje nga aplikimi i këtyre tarifave, përzgjedhja duhet të jetë "Jo".	
1.6.5	Aplikimi i kthimit të investimeve të parrealizuara	Po/Jo	Kjo mundëson kompensimin e konsumatorëve në rastin e investimeve kapitale të parrealizuara që ishin planifikuar në rishikimet e kaluara, por që nuk janë realizuar. Kjo do të aplikohet vetëm nga rishikimi i tarifave për periudhën 2029-2031 e tutje.	

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2	Të dhëna teknike dhe komerciale			
2.1	Numri i konsumatorëve			
2.1.1	Numri i konsumatorëve të ujit		Ky seksion i referohet të gjithë konsumatorëve që janë të kycur në sistemin e furnizimit me ujë nga KRU	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2.1.1.1	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës			
2.1.1.1.1	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës në fund të vitit	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës në fund të vitit, para vitit bazë, pra për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028 me vitin bazë 2025, ky është numri i regjistruar i konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës në fund të vitit 2024.	
2.1.1.1.2	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës që kanë ndryshuar statusin në konsumatorë shtëpiak me ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak që më parë nuk kishin ujëmatës dhe që kanë instaluar një ujëmatës (ose disa ujëmatës) gjatë vitit.	
2.1.1.1.3	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës që kanë ndryshuar statusin në konsumatorë shtëpiak pa ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak që më parë kishin ujëmatës dhe që kanë hequr ujëmatësin(it) e tyre në mënyrë të përhershme. Kjo nuk përfshin konsumatorët ku ujëmatësi është hequr përkohësisht në qëllim të zëvendësimit ose riparimit. ARRU pret që ky numër të jetë zero, por mund të ketë disa raste ku kjo aplikohet.	
2.1.1.1.4	Kyçjet e reja të konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës	Numri	Numri i kyçjeve të reja të konsumatorëve shtëpiak të instaluara me ujëmatës. Kjo NUK përfshin ata konsumatorë që janë tashmë të lidhur pa ujëmatës, por që kanë instaluar ujëmatës. Këta përfshihen në pikën 2.1.1.1.2 më sipër.	
2.1.1.1.5	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve shtëpiak me kyçje të reja me ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak të parregjistruar (të paligjshëm) që janë tashmë të lidhur me sistemin dhe që janë regjistruar në sistemin e faturimit gjatë vitit dhe kanë ujëmatës të instaluar. Rregullimi i këtyre konsumatorëve do të jetë një faktor kryesor në reduktimin e humbjeve të dukshme.	
2.1.1.1.6	Shkyçjet e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak që janë shkycur gjatë vitit.	
2.1.1.2	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës			
2.1.1.2.1	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit para vitit bazë, pra për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028 me vitin bazë 2025, ky është numri i regjistruar i konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit 2024.	
2.1.1.2.2	Kyçjet e reja të konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës	Numri	Megjithëse nuk priten kyçje të reja të konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës, kjo pikë është përfshirë në model nëse kërkohet. ARRU nuk pret kyçje të reja pa ujëmatës.	
2.1.1.2.3	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve shtëpiak me kyçje të reja pa ujëmatës	Numri	Po ashtu, ARRU nuk pret rregullimin e kyçjeve të parregjistruara (të paligjshme) të konsumatorëve shtëpiak duke u ofruar kyçje pa ujëmatës, por është përfshirë në model nëse kërkohet.	
2.1.1.2.4	Shkyçjet e konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës që janë shkycur gjatë vitit. Kjo NUK përfshin ndryshimin e statusit të kyçjeve pa ujëmatës në kyçje me ujëmatës (2.1.1.1.2 më sipër).	
2.1.1.3	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës			

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2.1.1.3.1	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës në fund të vitit	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit para vitit bazë, pra për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028 me vitin bazë 2025, ky është numri i regjistruar i konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit 2024.	
2.1.1.3.2	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës që kanë ndryshuar statusin në konsumatorë jo-shtëpiak me ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak që më parë nuk kishin ujëmatës dhe që kanë instaluar një ujëmatës (ose disa ujëmatës) gjatë vitit. ARRU supozon se të gjithë konsumatorët jo-shtëpiak janë me ujëmatës dhe nuk priten të ndryshojnë statusin e konsumatorit, por kjo pikë është përfshirë në model nëse kërkohet.	
2.1.1.3.3	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës me status të ndryshuar në konsumatorë jo-shtëpiak pa ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak që më parë kishin ujëmatës dhe që kanë hequr ujëmatësin(it) e tyre në mënyrë të përhershme. Kjo nuk përfshin konsumatorët ku ujëmatësi është hequr për kohësiht në qëllim të zëvendësimit ose riparimit. ARRU pret që ky numër të jetë zero, por mund të ketë disa raste ku kjo aplikohet.	
2.1.1.3.4	Kyçjet e reja të konsumatorëve jo-shtëpiak me ujëmatës	Numri	Numri i kyçjeve të reja të konsumatorëve jo-shtëpiak të instaluar me ujëmatës. Kjo NUK përfshin ata konsumatorë që janë tashmë të lidhur pa ujëmatës, por që kanë instaluar ujëmatës. Këta përfshihen në pikën 2.1.1.3.2 më sipër.	
2.1.1.3.5	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve jo-shtëpiak me kyçje të reja me ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak të parregjistruar (të paligjshëm) që janë tashmë të lidhur me sistemin dhe që janë regjistruar në sistemin e faturimit gjatë vitit dhe kanë ujëmatës të instaluar. Rregullimi i këtyre konsumatorëve do të jetë një faktor kryesor në reduktimin e humbjeve të dukshme.	
2.1.1.3.6	Shkyçjet e konsumatorëve jo-shtëpiak me ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak që janë shkyçur gjatë vitit.	
2.1.1.4	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës			
2.1.1.4.1	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit para vitit bazë, pra për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028 me vitin bazë 2025, ky është numri i regjistruar i konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës në fund të vitit 2024. ARRU pret që të ketë shumë pak kyçje të konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës.	
2.1.1.4.2	Kyçjet e reja të konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës	Numri	Megjithëse nuk priten kyçje të reja të konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës, kjo pikë është përfshirë në model nëse kërkohet. ARRU nuk pret kyçje të reja pa ujëmatës.	
2.1.1.4.3	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve jo-shtëpiak me kyçje të reja pa ujëmatës	Numri	Po ashtu, ARRU nuk pret rregullimin e kyçjeve të parregjistruara (të paligjshme) të konsumatorëve jo-shtëpiak duke u ofruar kyçje pa ujëmatës, por është përfshirë në model nëse kërkohet.	
2.1.1.4.4	Shkyçjet e konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës që janë shkyçur gjatë vitit. Kjo NUK përfshin ndryshimin e statusit të kyçjeve pa ujëmatës në kyçje me ujëmatës (2.1.1.3.2 më sipër).	

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2.1.2	Numri i konsumatorëve të ujit dhe ujërave të ndotura			
2.1.2.1	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura		Ky seksion i referohet të gjithë konsumatorëve që janë të kyçur në sistemin e furnizimit me ujë nga KRU dhe që gjithashtu janë të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura të KRU-së	
2.1.2.1.1	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit	Numri	Ashtu si në seksionin 2.1.1.1 por i kufizuar vetëm për ata konsumatorë që gjithashtu janë të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura të KRU-së.	
2.1.2.1.2	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës që kanë ndryshuar statusin në konsumatorë shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.1.3	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës që kanë ndryshuar statusin në konsumatorë shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.1.4	Konsumatorët e rinj shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.1.5	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve shtëpiak me kyçje të reja me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.1.6	Shkyçjet e konsumatorëve shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.2	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura			
2.1.2.2.1	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit	Numri	Ashtu si në seksionin 2.1.1.2 por i kufizuar vetëm për ata konsumatorë që gjithashtu janë të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura të KRU-së.	
2.1.2.2.2	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.2.3	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve shtëpiak me kyçje të reja pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2.1.2.2.4	Shkyçjet e konsumatorëve shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.3	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura			
2.1.2.3.1	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit	Numri	Ashtu si në seksionin 2.1.1.3 por i kufizuar vetëm për ata konsumatorë që gjithashtu janë të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura të KRU-së.	
2.1.2.3.2	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës që kanë ndryshuar statusin në konsumatorë jo-shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.3.3	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës që kanë ndryshuar statusin në konsumatorë jo-shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.3.4	Konsumatorët e rinj jo-shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.3.5	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve jo-shtëpiak me kyçje të reja me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.3.6	Shkyçjet konsumatorëve jo-shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.4	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura			
2.1.2.4.1	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit	Numri	Ashtu si në seksionin 2.1.1.4 por i kufizuar vetëm për ata konsumatorë që gjithashtu janë të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura të KRU-së.	
2.1.2.4.2	Konsumatorët e rinj jo-shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.2.4.3	Rregullimi i kyçjeve të paligjshme të konsumatorëve jo-shtëpiak me kyçje të reja pa	Numri		

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
	Ujëmatës të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura			
2.1.2.4.4	Shkycqet e konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri		
2.1.3	Vetëm numri i konsumatorëve për ujërat e ndotura		Të dhënat në lidhje me konsumatorët që janë të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura të KRU-së, por që nuk janë të kycur në sistemin e furnizimit me ujë të KRU-së.	
2.1.3.1	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura			
2.1.3.1.1	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura por që nuk janë të kycur në sistemin e ujësjellësit të KRU-së në fund të vitit para vitit bazë, d.m.th për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028 me vit bazë 2025 ky është numri i regjistruar i konsumatorëve shtëpiak të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit 2024.	
2.1.3.1.2	Konsumatorët e rinj shtëpiak të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri	Numri i konsumatorëve të rinj shtëpiak të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura, por që nuk janë të kycur në sistemin e furnizimit me ujë të KRU-së gjatë vitit.	
2.1.3.1.3	Konsumatorët shtëpiak të shkycur vetëm nga rrjeti i ujërave të ndotura	Numri	Numri i konsumatorëve shtëpiak të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura, por që nuk janë të kycur në sistemin e furnizimit me ujë të KRU-së që janë shkycur nga sistemi i ujërave të ndotura gjatë vitit.	
2.1.3.2	Konsumatorët jo-shtëpiak të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura			
2.1.3.2.1	Konsumatorët jo-shtëpiak të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak me kyçje në rrjetin e ujërave të ndotura por që nuk janë të kycur në sistemin e ujësjellësit të KRU-së në fund të vitit para vitit bazë, d.m.th për rishikimin e tarifave për periudhën 2026-2028 me vit bazë 2025 ky është numri i regjistruar i konsumatorëve shtëpiak të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura në fund të vitit 2024.	
2.1.3.2.2	Konsumatorët e rinj jo-shtëpiak të kycur vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura	Numri	Numri i konsumatorëve të rinj jo-shtëpiak të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura, por që nuk janë të kycur në sistemin e furnizimit me ujë të KRU-së gjatë vitit.	
2.1.3.2.3	Konsumatorët e jo-shtëpiak të shkycur vetëm nga rrjeti i ujërave të ndotura	Numri	Numri i konsumatorëve jo-shtëpiak të kycur në rrjetin e ujërave të ndotura, por që nuk janë të kycur në sistemin e furnizimit me ujë të KRU-së që janë shkycur nga sistemi i ujërave të ndotura gjatë vitit.	
2.2	Numrat e konsumatorëve i nënshtrohen tarifave për përforcimin e infrastrukturës		Referojni udhëzimeve të ARRU-së për tarifat e përforcimit të infrastrukturës	
2.2.1	Tarifat e ujit			
2.2.1.1	Konsumatorët e rinj shtëpiak të ujit i nënshtrohen tarifave të përforcimit	Numri	Numri i konsumatorëve të rinj shtëpiak të ujit NETO në vit që i nënshtrohen tarifës për përforcimin e infrastrukturës . Referojni udhëzimeve për tarifën e përforcimit të infrastrukturës për përcaktimet dhe mënyrën se si përcaktohen konsumatorët e rinj shtëpiak neto.	

Udhëzuesi i përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2.2.1.2	Konsumatorët e rinj jo-shtëpiak të ujit i nënshtrohen tarifave të përforcimit	Numri	Numri i konsumatorëve të rinj jo-shtëpiak të ujit NETO në vit që i nënshtrohen tarifës për përforcimin e infrastrukturës. Referojuni udhëzimeve për tarifën e përforcimit të infrastrukturës për përcaktimet dhe mënyrën se si përcaktohen konsumatorët e rinj jo-shtëpiak neto.	
2.2.1.3	Konsumatorët e rinj jo-shtëpiak të ujit i nënshtrohen tarifave të shndërruar në ekuivalentin e konsumatorëve të shtëpiak	Numri	Numri i shndërruar i konsumatorëve të rinj jo-shtëpiak të ujit NETO në vit që i nënshtrohen tarifës për përforcimin e infrastrukturës të shndërruar në ekuivalentin e konsumatorëve të tyre shtëpiak. Referojuni udhëzimeve për tarifën e përforcimit të infrastrukturës për mënyrën se si ndryshohet statusi i konsumatorëve e rinj jo-shtëpiak neto.	
2.2.2	Tarifat për ujërat e ndotura			
2.2.2.1	Konsumatorët e rinj shtëpiak të kycur në sistemin e ujërave të ndotura i nënshtrohen tarifave të përforcimit	Numri	Numri i konsumatorëve të rinj shtëpiak të ujërave të ndotura NETO në vit që i nënshtrohen tarifës për përforcimin e infrastrukturës. Referojuni udhëzimeve për tarifën e përforcimit të infrastrukturës për përcaktimet dhe mënyrën se si përcaktohen konsumatorët e rinj shtëpiak neto.	
2.2.2.2	Konsumatorët e rinj jo-shtëpiak të kycur në sistemin e ujërave të ndotura i nënshtrohen tarifave të përforcimit	Numri	Numri i konsumatorëve të rinj jo-shtëpiak të ujërave të ndotura NETO në vit që i nënshtrohen tarifës për përforcimin e infrastrukturës. Referojuni udhëzimeve për tarifën e përforcimit të infrastrukturës për përcaktimet dhe mënyrën se si përcaktohen konsumatorët e rinj jo-shtëpiak neto.	
2.2.2.3	Konsumatorët e rinj jo-shtëpiak të kycur në sistemin e ujërave të ndotura që i nënshtrohen tarifave të përforcimit të shndërruar në ekuivalentin e konsumatorëve të shtëpiak	Numri	Numri i shndërruar i konsumatorëve të rinj jo-shtëpiak të ujërave të ndotura NETO në vit që i nënshtrohen tarifës për përforcimin e infrastrukturës të shndërruar në ekuivalentin e konsumatorëve të tyre shtëpiak. Referojuni udhëzimeve për tarifën e përforcimit të infrastrukturës për mënyrën se si ndryshohet statusi i konsumatorëve e rinj jo-shtëpiak neto.	
2.3	Kërkesa e konsumatorëve			
2.3.1	Kërkesa për konsum shtëpiak			
2.3.1.1	Konsumatorët shtëpiak me ujëmatës	litra/konsumator/ditë	Konsumi mesatar ditor nga konsumatorët shtëpiak me ujëmatës bazuar në të dhënat e faturimit të matur nga KRU. ARRU që kjo vlerë të rritet çdo vit për shkak të programit të riparimit dhe zëvendësimit të ujëmatësve të KRU-ve, ku ujëmatësit me defekte përgjithësisht rezultojnë në lexime që janë më të vogla se konsumi aktual. ARRU kërkohet që kjo rritje e pritshme e konsumit të bazohet në evidencën më të mirë të disponueshme të nën-leximeve mesatare të ujëmatësve dhe ritmin e pritshëm të programit të riparimit/ndërrimit të ujëmatësve. Kjo rritje e shijëve të matura është kontribut i madh drejt zvogëllimit të humbjeve të dukshme. ARRU pret që KRU-të të përshijë prftshmëri reale, por megjithatë sfidues për reduktimin e humbjeve të dukshme përmes programit të riparimit/ndërrimit të ujëmatësve.	
2.3.1.2	Konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës	litra/konsumator/ditë	Kjo vlerë është një vlerësim i konsumit mesatar të pamatur nga konsumatorët shtëpiak pa ujëmatës. ARRU pret që kjo vlerë të jetë pak më e lartë sesa për konsumin e matur për shkak të efekteve të sjelljes së konsumatorëve për përdorimin e ujit të pamatur.	
2.3.2	Kërkesa për ujë jo-shtëpiak			

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2.3.2.1	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës	m ³ në vit	Konsumi vjetor i vlerësuar nga kyqjet e konsumatorëve jo-shtëpiak me ujëmatës. Kjo do të bazohet në të dhënat e faturimit të KRU-ve dhe pritjet e bazuara në dëshmi për rritjen e konsumit nga konsumatorët ekzistues jo-shtëpiak.	
2.3.2.2	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës	m ³ në vit	ARRU nuk pret që të regjistrohet konsumi nga konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës, por ky zë përfshihet nëse kërkohet.	
2.3.2.3	Konsumatorët jo-shtëpiak me ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	m ³ në vit	Konsumi vjetor i vlerësuar nga kyqjet e konsumatorëve jo-shtëpiak me ujëmatës që gjithashtu janë të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura. Kjo do të bazohet në të dhënat e faturimit të KRU-ve dhe pritjet e bazuara në dëshmi për rritjen e konsumit nga konsumatorët e rinj jo-shtëpiak dhe rritjen e konsumit nga konsumatorët ekzistues jo-shtëpiak.	
2.3.2.4	Konsumatorët jo-shtëpiak pa ujëmatës të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura	m ³ në vit	Konsumi vjetor i vlerësuar nga kyqjet e konsumatorëve jo-shtëpiak pa ujëmatës që gjithashtu janë të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura. Kjo do të bazohet në të dhënat e faturimit të KRU-ve dhe pritjet e bazuara në dëshmi për rritjen e konsumit nga konsumatorët e rinj jo-shtëpiak dhe rritjen e konsumit nga konsumatorët ekzistues jo-shtëpiak.	
2.3.3	Shitjet e ujit të trajtuar me shumicë			
2.3.3.1	Vëllimi i ujit të trajtuar me shumicë të shitur	m ³ në vit	Vëllimi i vlerësuar i ujit të trajtuar me shumicë që i është shitur KRU-ve të tjera ose ofruesve të shërbimeve.	
2.3.4	Ujërat e ndotura të gjeneruara vetëm nga konsumatorët shtëpiak të ujërave të ndotura	litra/konsumator/ditë		
2.3.4.1	Mesatarja e ujërave ndotura të gjeneruara vetëm nga konsumatorët shtëpiak të ujërave të ndotura	litra/konsumator/ditë	Mesatarja e vlerësuar e ujërave të ndotura të gjeneruara vetëm nga konsumatorët shtëpiak të ujërave të ndotura KRU do ta vlerësojë këtë bazuar në dëshmitë më të mira në dispozicion dhe vlerësimin inxhinierik. Numri i konsumatorëve në këtë kategori pritet të jetë i vogël dhe pasaktësitë nuk ka gjasa të kenë ndikim material në tarifën e përcaktuar.	
2.4	Ecuria e arkëtitimit së të ardhurave			
2.4.1	Konsumatorët shtëpiak	% faturimi	Ecuria e vlerësuar e arkëtitimit së të ardhurave lidhet me konsumatorët shtëpiak dhe jo-shtëpiak. Kjo është përqindja e shumave të faturuara që KRU pret të arkëtojë si pagesa, ndërsa bilanci do të shënohet si borxhe të këqija. Ai përfshin shumat e faturuara që pritet të paguhen me vonesë pas përpjekjeve më intensive për arkëtimin e të ardhurave. Në rastin e konsumatorëve jo-shtëpiak, ARRU pret që të ardhurat e pa-arkëtuara të zbatohen vetëm për bizneset që kanë ndërprerë aktivitetet. Pritshmëria afatgjatë e ARRU është që arkëtimi i të ardhurave nga konsumatorët shtëpiak dhe jo-shtëpiak duhet të jetë afër 100%.	
2.4.2	Konsumatorët jo-shtëpiak	% faturimi		
2.5	Karakteristikat e cilësisë së ujërave të ndotura		Zbatohet vetëm nëse aplikohen tarifa në bazë të cilësisë së efluentit.	
2.5.1	Faktori mesatar i kthimit nga ujërat e ndotura	%	Përqindja mesatare e ujit të furnizuar për të gjithë konsumatorët që shkakohet në sistemin e ujërave të ndotura. Kjo përjashton ujin që futet në sistem nga hyrja dhe ujin e shkakuar në sistemin e ujërave të ndotura që gjenerohet nga burimet ujore që nuk janë të KRU-së. Përcaktimi i faktorit të kthimit	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
2.5.2	Kërkesa kimike për oksigjen (COD) e ujërave të ndotura të papërpunuara (O ₅)	mg/l	duket të bazohet në prova kur është e mundur. ARRU pret që faktori i kthimit të jetë në masën 90%-95%.	
2.5.3	Totali i lëndëve të ngurta të pezulluara të ujërave të ndotura të papërpunuara (S _s)	mg/l	Kërkesa e matur kimike për oksigjen (COD) e ujërave të ndotura të papërpunuara pas vendosjes të qetë për një orë në pH 7 (mg/l) në kushtet e rrjedhës së motit të thatë, e përcaktuar përmes testeve laboratorike.	
2.6	Tarifat për cilësinë e ujërave të ndotura (nivelet e çmimeve 2024)		Totali i lëndëve të ngurta të pezulluara të ujërave të ndotura të papërpunuara të matura në pH 7 (EUR/m ³) në kushtet e rrjedhës së motit të thatë të përcaktuar nëpërmjet testeve laboratorike.	
2.6.1	Trajtim biologjik (B)	EUR/kg COD	Kostoja e përlogaritur e trajtimit biologjik (duke përfshirë kostot e kapitalit të trajtuara në formë anuiteti) për kg COD. Bazuar në projektet e fundit në Kosovë dhe duke përdorur krahasimet ndërkombëtare, ARRU vlerëson se kjo është 0.3600 euro / kg në nivelet e çmimeve të vitit 2025. KRU mund të paraqesë dëshmi mbështetëse për të propozuar një tarifë alternative e cila do të shqyrtohet nga ARRU. Kjo nuk zbatohet nëse KRU bën kërkesë dhe siguron një përjashtim që e liron atë nga aplikimi i tarifave për mbeturinat tregtare.	
2.6.2	Derdhja e llumit (S)	EUR/kg COD	Kostoja e përlogaritur për trajtimin dhe derdhjen e llumit (duke përfshirë kostot e kapitalit të trajtuara në formë anuiteti për objektet e trajtimit dhe derdhjes) për çdo kilogram TSS. Bazuar në projektet e fundit në Kosovë dhe duke përdorur krahasimet ndërkombëtare, ARRU vlerëson se kjo është 0.2600 euro / kg në nivelet e çmimeve të vitit 2025. KRU mund të paraqesë dëshmi mbështetëse për të propozuar një tarifë alternative e cila do të shqyrtohet nga ARRU. Kjo nuk zbatohet nëse KRU bën kërkesë dhe siguron një përjashtim që e liron atë nga aplikimi i tarifave për mbeturinat tregtare.	
2.6.3	T1 tarifa fikse shitesë	EUR/muaj	Kjo është një tarifë fikse shitesë për konsumatorët e Nivelit 1 për të mbuluar shpenzimet e KRU-ve në lidhje me inspektimin rutinor të konsumatorëve të Nivelit 1 dhe verifikimin e pavarur të të dhënave të dorëzuara.	
2.6.4	Tarifa minimale për ujërave të ndotura jo-shitepiake	EUR/m3	Një tarifë minimale për të shmangur anomalinë e zbriljeve të mbeturinave industriale që rezulton në tarifa negative.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
3	Humbjet në hyrje		Kjo fletë pune nuk ka ndikim të drejtpërdrejtë në përcaktimin e tarifave. Ajo ofron informacion në lidhje me humbjet që ia mundëson ARRU-së të vlerësojë reduktimin e dukshëm të humbjeve të parashikuara nga rritja e konsumit mesatar të ujit të matur dhe rregullimin e konsumatorëve të peregjistruar (të paligjshëm).	
3.1	Bilanci i ujit nëse i nënshtrohet testeve në terren			
3.1.1	Prodhimi i ujit			
3.1.1.1	Prodhimi i ujit	m ³ /vit	Prodhimi total vjetor i matur i ujit që hyn në rrjetin e ujësjellësit. Kjo nuk përfshin prodhimin e ujit që përdoret në procesin e prodhimit, p.sh. filtrat pastrues rikthyes.	
3.1.2	Konsumi i ujit			
3.1.2.1	Konsumi i autorizuar i ujit të matur dhe të faturuar	m ³ /vit	Konsumi total vjetor i autorizuar i ujit nga konsumatorët me ujëmatës bazuar në të dhënat e faturimit.	
3.1.2.2	Konsumi i autorizuar i ujit të pamatur dhe të faturuar	m ³ /vit	Konsumi total vjetor i autorizuar i ujit nga konsumatorët pa ujëmatës bazuar në të dhënat e faturimit, cili bazohet në konsumin e vlerësuar.	
3.1.2.3	Konsumi i autorizuar i ujit të pamatur dhe të pafaturuar (p.sh. objektet fetare)	m ³ /vit	Konsumi total vjetor i autorizuar i ujit nga konsumatorët me ujëmatës por që është i pafaturuar, p.sh. objektet fetare.	
3.1.2.4	Konsumi i ujit të pamatur dhe të pafaturuar (p.sh. objektet fetare)	m ³ /vit	Konsumi total vjetor i autorizuar i ujit nga konsumatorët pa ujëmatës por që është i pafaturuar, p.sh. objektet fetare.	
3.1.3	Humbjet e dukshme			
3.1.3.1	Konsumimi i paautorizuar, p.sh. kycjet e paligjshme	m ³ /vit	Konsum i paautorizuar nga kycjet e peregjistruara/paligjshme	
3.1.3.2	Pasaktësitë e ujëmatësve	m ³ /vit	Humbjet e dukshme të vlerësuara nga pasaktësitë e ujëmatësve. Kjo duhet të përcaktohet përmes analizës statistikore të testimit të ujëmatësve për të përcaktuar nën-leximet që lidhen me jetëgjatësinë e ujëmatësve.	
3.1.4	Humbjet reale			
3.1.4.1	Rrjedhjet nga tejmbushjet e rezervuarëve	m ³ /vit	Rrjedhjet vjetore të vlerësuara nga tejmbushjet e rezervuarëve të KRU-së, ku është e mundur të përcaktohet.	
3.1.4.2	Rrjedhjet në sistemet e shtrirjes dhe distribuimit të bypave	m ³ /vit	Rrjedhjet e vlerësuara brenda rrjetit të distribuimit duke përfshijtur humbjet nga kycjet e furnizimit.	
3.1.4.3	Rrjedhjet në kycjet e furnizimit	m ³ /vit	Rrjedhjet vjetore të vlerësuara nga kycjet e furnizimit.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
3.1.5	Kontrolli i bilancit			
3.1.5.1	Bilanci i ujit (duhet të jetë 0)	m ³ /vit	Llogaritja kontrollues mbi bilancin e ujit. Kjo shifër duhet të jetë zero.	
3.2	Bilanci i ujit pa teste në terren			
3.2.1	Humbjet			
3.2.1.1	Humbjet totale reale dhe të dukshme	m ³ /vit	Humbjet totale vjetore të vlerësuara (reale dhe të dukshme) nëse nuk përcaktohet zërbërthimi i humbjeve, d.m.th prodhimi total minus shitjet.	
3.3	Ndryshimi i shprehisë së konsumit si rezultat i legalizimit të kyçjeve dhe përmirësimit i matjes			
3.3.1	Konsumi pas legalizimit të kyçjeve si përqindje e reduktimit të humbjeve të dukshme	%	Vlera mesatare e rritjes së konsumit të faturuar nga rregullimi i konsumatorëve të parregjistruar si përqindje e reduktimit të pritsëm të humbjeve të dukshme, ndryshimi është një përgjigje e sjelljes ndaj faturimit.	
3.3.2	Rritja e konsumit të matur nga konsumatorët ekzistues të matur si përqindje e reduktimit të humbjeve të dukshme	%	Vlera mesatare e rritjes së konsumit të faturuar nga matja e përmirësuar si përqindje e reduktimit të pritsëm të humbjeve të dukshme, ndryshimi është një përgjigje e sjelljes ndaj faturimit.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
4	Tarifat për kyçje dhe përfordimin e infrastrukturës			
4.1	Kyçjet - uji			
4.1.1	Numri i kyçjeve të reja që i nënshtrohen tarifave për kyçje			
4.1.1.1;	Madhësia e kyçjes së re	Numri	Numri i kyçjeve të reja të parashikuara të ujit në çdo vit sipas madhësisë së kyçjes.	
4.1.1.1.1				
4.1.2	Tarifa mesatare e kyçjes duke përfshirë tarifën e inspektimit			
4.1.2.1;	Madhësia e kyçjes	EUR/kyçje	Kostoja mesatare për kyçje të re të ujit duke përfshirë tarifën e inspektimit në nivelet e çmimeve të vitit bazë. Tarifa individuale për kyçje mund të ndryshojë sipas llojit të kyçjes, p.sh. brenda një ndërtese, në rrugë dhe kriteret tjera. Shuma e futur në model duhet të jetë mesatarja e kostos së kyçjeve të reja sipas madhësisë së kyçjes. Kjo do të përcaktohet nga një analizë e tarifave mesatare të kyçjeve të kaluar (sipas madhësisë së kyçjes) dhe do të parashikohet për të ardhmen.	
4.1.2.1.1				
4.2	Kyçjet - ujërat e ndotura			
4.2.1	Numri i kyçjeve të reja që i nënshtrohen tarifave për kyçje			
4.2.1.1-4.2.1.6	Madhësia e kyçjes	Numri	Numri i kyçjeve të reja të parashikuara të ujërave të ndotura në çdo vit sipas madhësisë së kyçjes.	
4.2.2	Tarifa mesatare e kyçjes duke përfshirë tarifën e inspektimit			
4.2.2.1;	Madhësia e kyçjes	EUR/kyçje	Kostoja mesatare për kyçje të re të ujërave të ndotura duke përfshirë tarifën e inspektimit në nivelet e çmimeve të vitit bazë. Tarifa individuale për kyçje mund të ndryshojë sipas llojit të kyçjes, p.sh. brenda një ndërtese, në rrugë dhe kriteret tjera. Shuma e futur në model duhet të jetë mesatarja e kostos së kyçjeve të reja sipas madhësisë së kyçjes. Kjo do të përcaktohet nga një analizë e tarifave mesatare të kyçjeve të kaluar (sipas madhësisë së kyçjes) dhe do të parashikohet për të ardhmen.	
4.2.2.6				
4.3	Tarifat për përfordimin e infrastrukturës			
4.3.1	Uji	EUR/kyçje	Tarifa e aplikueshme për lidhjet e reja të ujit neto si kontribut për ndërtimin e përfordimit të rrjetit për shkak të ndikimit kumulativ të zhvillimeve të reja. ARRU ka caktuar tarifën prej 130.00 euro për kyçje të re neto (në nivelet e çmimeve të vitit bazë).	
4.3.2	Ujërat e ndotura	EUR/kyçje	Tarifa e aplikueshme për lidhjet e reja të ujërave të ndotura neto si kontribut për ndërtimin e përfordimit të rrjetit për shkak të ndikimit kumulativ të zhvillimeve të reja. ARRU ka caktuar tarifën prej 90.00 euro për kyçje të re neto (në nivelet e çmimeve të vitit bazë).	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
5	Tarifat fikse			
5.1	Kyçjet me ujëmatës			
5.1.1	Kyçjet me ujëmatës në fillim të vitit			
5.1.1.1; 5.1.1.16	Madhësia e kyçjes	Numri	Numri i kyçjeve të ujit me ujëmatës sipas madhësisë së kyçjes në fillim të vitit të parë të periudhës së kontrollit të çmimeve.	
5.1.2	Kyçjet shtesë me ujëmatës gjatë vitit			
5.1.2.1	Madhësia e kyçjes	Numri	Numri i kyçjeve shtesë neto të projektuar të ujit me ujëmatës sipas madhësisë së kyçjes gjatë çdo viti të periudhës së kontrollit të çmimeve. Konsumatorët që kanë ndryshuar statusin nga kyçjet pa ujëmatës në kyçje me ujëmatës për t'u përfshirë si kyçje e re me ujëmatës. Këto janë kyçje të reja neto, d.m.th kyçjet e reja minus shkyçjet.	
5.2	Kyçjet pa ujëmatës			
5.2.1	Kyçjet pa ujëmatës në fillim të vitit			
5.2.1.1; 5.2.1.16	Madhësia e kyçjes	Numri	Numri i kyçjeve të ujit pa ujëmatës sipas madhësisë së kyçjes në fillim të vitit të parë të periudhës së kontrollit të çmimeve.	
5.2.2	Kyçjet shtesë pa ujëmatës gjatë vitit			
5.2.2.1	Madhësia e kyçjes	Numri	Numri i kyçjeve shtesë neto të projektuar të ujit pa ujëmatës sipas madhësisë së kyçjes gjatë çdo viti të periudhës së kontrollit të çmimeve. Konsumatorët që kanë ndryshuar statusin nga kyçjet pa ujëmatës në kyçje me ujëmatës për t'u futur si vlerës negative. Këto janë kyçje të reja neto, d.m.th kyçjet e reja minus shkyçjet minus kyçjet pa ujëmatës të shndërruara me kyçje me ujëmatës.	
5.3	Kyçjet vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura			
5.3.1	Kyçjet vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura në fillim të vitit	Numri	Numri i konsumatorëve (shtëpiak dhe jo-shtëpiak) të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura por që nuk janë të kyçur në rrjetin e furnizimit me ujë të KRU-së në fillim të vitit të parë të periudhës së kontrollit të çmimeve.	
5.3.2	Kyçja vetëm në rrjetin e ujërave të ndotura shtesë gjatë vitit	Numri	Numri i konsumatorëve shtesë (shtëpiak dhe jo-shtëpiak) të kyçur në rrjetin e ujërave të ndotura por që nuk janë të kyçur në rrjetin e furnizimit me ujë të KRU-së gjatë çdo viti të periudhës së kontrollit të çmimeve.	
5.4	Tarifa fikse			
5.4.1	Vetëm konsumatorët e ujërave të ndotura	EUR/muaj	Tarifa fikse e propozuar (niveli i çmimeve të vitit bazë) vetëm për kyçjet e ujërave të ndotura.	
5.4.2 – 5.4.17	Madhësia e kyçjes	EUR/muaj	Tarifa fikse e propozuar (niveli i çmimeve të vitit bazë) vetëm për kyçjet e furnizimit me ujë sipas madhësisë së kyçjes.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
6	Tarifat e vlerësuara për ujërat e ndotura			
	Skema duhet të plotësohet nga KRU	m ³ /vit	<p>Kjo fletë pune ka për qëllim të listojë gjithë konsumatorët jo-shtëpiak ku shkarkimi i ujërave të ndotura nuk pasqyrohet s'hyrje e furnizimit me ujë. Kjo mund të ndodhë kur konsumatorët nxjerrin ujë nga burime të tjera dhe e shkarkojnë mbeturinën e tyre në sistemin e ujërave të ndotura të KRU-së, ose konsumojnë sasi të konsiderueshme uji, por shkarkojnë shumë pak mbeturinë në sistemin e ujërave të ndotura të KRU-së. KRU do të bëjë planifikimin e konsumatorëve të identifikuar dhe do të shënojë konsumimin e parashikuar të ujit dhe gjenerimin e projektuar të ujërave të ndotura.</p> <p>Kjo skemë duhet të përfshijë ata konsumatorë jo-shtëpiak të cilët i shkarkojnë mbeturinën e tyre në sistemin e ujërave të ndotura, por nuk janë të kyçur në ujësjellësin e KRU-së, d.m.th. hyrja e tyre e ujit në KRU do të ishte zero.</p> <p>Vëllimi i ujërave të ndotura të gjeneruara duhet të përcaktohet përmes hetimit me çfarëdo mjeti që është më i përshtatshëm. Kjo mund të përfshijë matjen e ujëmatës të rrjedhave të ujërave të ndotura, vlerësimin e ujit të futur nga burimet tjera dhe metodat tjera.</p> <p>Skema parashikon deri në 100 konsumatorë. Nëse nevojiten më shumë rreshta, kontaktoni ARRU-në për udhëzime.</p>	

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
7	<p>Konsumatorët e mbeturinave industriale - Niveli 1 (informacion konfidencial tregtar)</p> <p>Skema duhet të plotësohet nga KRU</p>	m ³ /vit dhe mg/l	<p>Kjo fletë pune ka për qëllim të listojë të gjithë konsumatorët industrialë të zonës specifike ku cilësia e ujërave të ndotura të tyre është dukshëm e ndryshme nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura. KRU do të listojë konsumatorët e identifikuar dhe do të shënojë hyrjen e parashikuar të ujit (duke përfshirë hyrjen e ujit nga rrjedhat e vlerësuara të ujit) dhe parametrat përkatës të cilësisë së efluentit (COD dhe TSS) për secilin konsumator. Këta parametra do të maten dhe verifikohen nga inspektimi i pavarur kur është e nevojshme.</p> <p>Referojuni udhëzimeve të ARRU-së për rregullimet e tarifimit të cilësisë së ujërave të ndotura për mënyrën e identifikimit të konsumatorëve të Nivelit 1.</p> <p>Të dhënat e futura në këtë fletë pune duhet të trajtohen si konfidenciale në aspektin tregtar dhe KRU nuk duhet t'i ndajë këto të dhëna me palë të jashtme përveç me ARRU-në për qëllime të përcaktimit të tarifave.</p> <p>Skema parashikon deri në 15 konsumatorë. Nëse nevojiten më shumë rreshta, kontaktoni ARRU-në për udhëzime.</p> <p>Nëse KRU-ja ka kërkuar dhe i është miratuar përjashtimi nga zbatimi i caktimit të tarifave bazuar në cilësinë e ujit, kjo fletë pune nuk është e aplikueshme për përcaktimin e tarifave dhe duhet të lihet bosh.</p>	

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
8	Konsumatorët e mbeturinave industriale - Niveli 2			
	Skema duhet të plotësohet nga KRU	m ³ /vit dhe mg/l	<p>Kjo fletë pune ka për qëllim të listojë të gjithë konsumatorët industrialë të industrisë specifike ku cilësia e ujërave të ndotura të tyre është dukshëm e ndryshme nga cilësia mesatare e ujërave të ndotura. KRU do të listojë grupet e identifikuar të konsumatorëve dhe do të shënojë hyrjen e parashikuar totale të ujit (duke përfshirë hyrjen e ujit nga rrjedhat e vlerësuara të ujit) nga secili grup dhe parametrat përkatës të cilësisë së efluentit (COD dhe TSS) për secilin grup të konsumatorëve.</p> <p>Modeli përfshin të dhëna nga WSRA të disa grupeve të industrisë dhe parametrat e parashikuar të cilësisë që do të aplikohen. ARRU mund të shtojë ose heqë grupe nga kjo skemë. Nëse KRU i konsideron parametrat si të pasaktë, KRU mund t'i ndryshojë ato në përputhje me rrethanat.</p> <p>Referojuni udhëzimeve të ARRU-së për rregullimet e tarifimit të cilësisë së ujërave të ndotura për mënyrën se si identifikohen dhe tarifohen konsumatorët e Nivelit 2.</p> <p>Skema parashikon deri në 15 grupe të konsumatorëve. Nëse nevojiten më shumë rreshta, kontaktoni ARRU-në për udhëzime.</p> <p>Nëse KRU-ja ka kërkuar dhe i është miratuar përjashtimi nga zbatimi i caktimit të tarifave bazuar në cilësinë e ujit, kjo fletë pune nuk është e aplikueshme për përcaktimin e tarifave dhe duhet të lihet bosh.</p>	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
9	Subvencionet operative			
9.1	Subvencionet operative për ujë			
9.1.1 – 9.1.10	Përshkrimi i subvencioneve	euro	Vlera e subvencioneve operative të parashikuara për shërbimet e furnizimit me ujë të pritshme në çdo vit të periudhës së kontrollit të çmimeve (e shndërruar në vlerat e vitit bazë).	
9.2	Subvencionet operative për ujërat e ndotura			
9.2.1 – 9.2.10	Përshkrimi i subvencioneve	euro	Vlera e subvencioneve operative të parashikuara për shërbimet e e ujërave të ndotura të pritshme në çdo vit të periudhës së kontrollit të çmimeve (e shndërruar në vlerat e vitit bazë).	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
11	Kostot operative - uji			
11.1	Burimet dhe trajtimi i ujit			
11.1.1	Tarifat për shërbime	EUR	Pagesat ndaj Ministrisë së Mjedisit për nxjerrjen e ujit dhe ndaj palëve të treta për furnizimin me shumicë të ujit të blerë.	
11.1.2	Kostot kimike	EUR	Kostot për blerjen e kimikateve për trajtimin e ujit në implantet e trajtimit. Kjo nuk përfshin kostot e kimikateve për trajtimin e nivelit të shpërndarjes në rrjedhën e poshtme, p.sh. dozimin e klorit brenda sistemit të shpërndarjes.	
11.1.3	Kostot e energjisë	EUR	Të gjitha kostot e energjisë që i atribuohen drejtpërdrejt aktivitetit të shërbimeve të burimeve ujore dhe trajtimit, por duke përfshuar energjinë e lëndëve djegëse fosile të përdorura për transport, që përfshihet në kostot e karburantit dhe me sigurimin e energjisë për depot dhe zyrat, të cilat përfshihen në kostot tjera direkte nëse ndërlikohen drejtpërdrejt me burimet ujore dhe trajtimin ose kostot tjera të biznesit.	
11.1.4	Kostot e karburantit	EUR	Kostot e karburantit të përdorur për transport në lidhje me burimet dhe trajtimin e ujit.	
11.1.5	Kostot e stafit	EUR	Pagat dhe medijet bruto të të gjithë punonjësve të përfshirë në aktivitetin e burimeve dhe trajtimit të ujit, duke përfshirë pagesat që rezultojnë nga skemat e bonuseve dhe pagesat e ndërlidhura me fitimin, kontributet e sigurimeve të punëdhënësve, detyrimet pensionale të pa financuarapa financuara, pagesat për sëmundje, përfitimet nga sëmundja, sigurimet private shëndetësore, shpërbimet për pensionim, përfitimet në rast vdekjeje gjatë shërbimit, pushimet me pagesë, shpenzimet për udhëtime dhe ato ditore si dhe shpenzimet për trajtime. Kur stafi punon në aktivitete të ndryshme, kostot e tyre duhet të ndahen në mes të aktiviteve, mundësisht duke përdorur fletët e vlyeshmërisë ose ndonjë metodë tjetër për regjistrimin direkt të kohës së shpenzuar në aktivitete individuale të shërbimit.	
11.1.6	Materialet dhe artikujt shpenzues	EUR	Të gjitha materialet dhe artikujt shpenzues që nuk përfshihen në shërbimet e kontraktuara apo të marrë me qira. Kjo kategori e kostove përfshin pajisjet (siç janë veglat e vogla dhe vesimbathjet), furnizimet, asfaltin dhe materialet mbushëse të lidhura me burimet ujore dhe trajtimin, por përjashton të gjithë zërat e kapitalizuar ose të përfshirë në shpenzimet për rinovimin e infrastrukturës.	
11.1.7	Shërbime të kontraktuara	EUR	Të gjitha pajisjet dhe shërbimet e marra me qira dhe të kontraktuara që ndërlikohen me burimet dhe trajtimin e ujit. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerive, pajisjeve për zyre dhe pajisjeve të përgjithshme, si dhe transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë gjithë fuqinë punëtore të kontraktuar dhe këshillimin profesional, siç janë avokatët dhe këshilltarët.	
11.1.8	Mirëmbajtja dhe riparimi	EUR	Kostot e mirëmbajtjes rutinore të infrastrukturës dhe asetëve jo infrastrukturorë të ndërlidhura me burimet dhe trajtimin e ujit. Përfshihen kostot e mirëmbajtjes së asetëve infrastrukturorë të cilat përfshihen në tarifën e rinovimit të infrastrukturës.	
11.1.9	Kostot tjera direkte	EUR	Çdo kosto tjetër operative që lidhet me burimet dhe trajtimin e ujit, por duke përfshuar interesin dhe tatimin. Përfshin kostot që ndërlikohen me sigurimin e laboratorëve, depove dhe zyrave të testimit të ujit, si dhe primet e sigurimit për aq sa ato ndërlikohen drejtpërdrejt me burimet dhe trajtimin e ujit.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
11.1.10	Rregullimi nga ARRU	EUR	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që ia mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të kostove operative të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare.	
11.1.11	Kostoja totale për burimet ujore dhe trajtimin	EUR	Totali i aktiviteve	
11.2	Distribuími i ujit			
11.2.1	Kostot kimike	EUR	Kostot për blerjen e kimikateve për trajtimin e ujit në nivel të distribuimit, p.sh. dozimi me klor brenda sistemit të distribuimit.	
11.2.2	Kostot e energjisë	EUR	Të gjitha kostot e energjisë që i atribuohen drejtpërdrejt distribuimit të ujit por duke përjashtuar energjinë e lëndëve djegëse fosile të përdorura për transport, që përfshihen në kostot e karburantit dhe me sigurimin e energjisë për zyrat, të cilat përfshihen në kostot tjera direkte nëse ndërlihen drejtpërdrejt me distribuimin e ujit ose kostot tjera të biznesit.	
11.2.3	Kostot e karburantit	EUR	Kostot e karburantit të përdorur për transport në lidhje me distribuimin e ujit, p.sh. automjetet e përdorura për ekipet e zbulimit të rrjedhjeve.	
11.2.4	Kostot e stafit	EUR	Pagat dhe mëditjet bruto të të gjithë punonjësve të përfshirë në aktivitetin e distribuimit të ujit, duke përfshirë pagesat që rezultojnë nga skemat e bonuseve dhe pagesat e ndërlihdura me fitimin, kontributet e sigurimeve të punëdhënësve, detyrimet pensionale të pa financuara, pagesat për sëmundje, përfitimet nga sëmundja, sigurimet private shëndetësore, shpërbimet për pensionim, përfitimet në rast vdekjeje gjatë shërbimit, pushimet me pagesë, shpenzimet për udhëtime dhe ato ditore si dhe shpenzimet për trajnime. Kur staffi punon në aktivitete të ndryshme, kostot e tyre duhet të ndahen në mes të aktiviteve, mundësisht duke përdorur fletët e vijueshmërisë ose ndonjë metodë tjetër për regjistrimin direkt të kohës së shpenzuar në aktivitete individuale të shërbimit.	
11.2.5	Materialet dhe artikujt shpenzues	EUR	Të gjitha materialet dhe artikujt shpenzues që nuk përfshihen në shërbimet e kontraktuara apo të marrë me qira. Kjo kategori e kostove përfshin pajisjet (siç janë veglat e vogla dhe veshmbathjet), furnizimet, asfaltin dhe materialet mbushëse të lihdura me distribuimin e ujit, por përjashton të gjithë zërat e kapitalizuar ose të përfshirë në shpenzimet për rinovimin e infrastrukturës.	
11.2.6	Shërbime të kontraktuara	EUR	Të gjitha pajisjet dhe shërbimet e marra me qira dhe të kontraktuara që ndërlihen me distribuimin e ujit. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerive, pajisjeve për zyrë dhe pajisjeve të përgjithshme, si dhe transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë gjithë fuqinë punëtore të kontraktuar dhe këshillimin profesional, siç janë avokatët dhe këshilltarët.	
11.2.7	Mirëmbajtja dhe riparimi	EUR	Kostot e mirëmbajtjes rutinore të infrastrukturës dhe asetëve jo infrastrukturorë të ndërlihdura me distribuimit me ujë. Përfashtohen kostot e mirëmbajtjes së asetëve infrastrukturorë të cilat përfshihen në tarifën e rinovimit të infrastrukturës.	
11.2.8	Kostot tjera direkte	EUR	Çdo kosto tjetër operative që lidhet me distribuimin e ujit, por duke përjashtuar interesin dhe tatimin. Përfshin kostot që ndërlihen me sigurimin e depove dhe zyrave, si dhe primet e sigurimit për aq sa ato ndërlihen drejtpërdrejt me distribuimin e ujit. Nuk përfshin interesat për kreditë.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
11.2.9	Rregullimi nga ARRU	EUR	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që ia mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të kostove operative të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare.	
11.2.10	Kostot totale të distribuimit të ujit	EUR	Totali i aktiviteve	
11.3	Aktivitetet afariste			
11.3.1	Tarifa për shërbime në bazë të ARRU-së, MMPH-së, SHUKOS-it, Odis Ekonomike, etj.	EUR	Të gjitha tarifat, abonimet dhe ngarkesat e tjera që ndërlihen me ARRU-në, MMPH-në, SHUKOS-in, Odis Ekonomike, etj.	
11.3.2	Kostot e energjisë	EUR	Të gjitha kostot e energjisë të ndara për ujë nuk zbatohen për burimet ujore, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit. Kjo përfshin energjinë për ndriçimin dhe ngrohjen e zyrave, depove, punëtorive etj. Kur objektet ndahen mes shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, kostot duhet të ndahen mes tyre.	
11.3.3	Kostot e karburantit	EUR	Të gjitha kostot e karburantit të ndara për ujë nuk zbatohen për burimet ujore, trajtimin dhe shpërndarjen e ujit. Kjo përfshin energjinë për ndriçimin dhe ngrohjen e zyrave, depove, punëtorive etj. Kur objektet ndahen mes shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, kostot duhet të ndahen mes tyre.	
11.3.4	Kostot e stafit	EUR	Pagat dhe mëdijet bruto të të gjithë punonjësve që nuk ndërlihen drejtpërdrejt me aktivitetin e burimeve, trajtimin dhe distribuimit të ujit, duke përfshirë pagesat që rezultojnë nga skemat e bonuseve dhe pagesat e ndërlihuara me fitimin, kontributet e sigurimeve të punëdhënësve, detyrimet pensionale të pa financuara, pagesat për sëmundje, përfitimet nga sëmundja, sigurimet private shëndetësore, shërbimet për pensionim, përfitimet në rast vdekjeje gjatë shërbimit, pushimet me pagese, shpenzimet për udhëtime dhe ato ditore si dhe shpenzimet për trajtime. Kur stafi punon në aktivitate të ndryshme, kostot e tyre duhet të ndahen në mes të aktiviteve, mundësisht duke përdorur fletët e vijueshmërisë ose ndonjë metodë tjetër për regjistrimin direkt të kohës së shpenzuar në aktivitate individuale të shërbimit.	
11.3.5	Materialet dhe artikujt shpenzues	EUR	Të gjitha materialet dhe artikujt shpenzues që nuk përfshihen në shërbimet e kontraktuara apo të marrë me qira dhe që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me burimet ujore dhe trajtimin dhe distribuimin e ujit. Kjo kategori e kostove përfshin pajisjet (siç janë kompjuterët dhe pajisjet përkatëse, materialet për zyre, mobillet për zyre, etj.).	
11.3.6	Shërbime të kontraktuara	EUR	Të gjitha pajisjet dhe shërbimet e marra me qira dhe të kontraktuara që nuk ndërlihen drejtpërdrejt me burimet ujore dhe trajtimin dhe distribuimin e ujit. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerive, pajisjeve për zyre dhe pajisjeve të përgjithshme, si dhe transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë gjithë fuqinë punëtore të kontraktuar dhe këshillimin profesional, siç janë avokatët dhe këshilltarët.	
11.3.7	Mirëmbajtja dhe riparimi	EUR	Kostot e mirëmbajtjes rutinore të aseteve jo infrastrukturore që nuk ndërlihen drejtpërdrejt me burimet ujore dhe trajtimin dhe distribuimin e ujit.	
11.3.8	Kostot tjera indirekte	EUR	Çdo kosto tjetër operative që nuk ndërlihet drejtpërdrejt me burimet ujore dhe trajtimin dhe shpërndarjen e ujit. Nuk përfshin interesat për kreditë.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
11.3.9	Rregullimi nga ARRU	EUR	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që ia mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të kostove operative të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare.	
11.3.10	Kostot totale të aktiviteteve afariste	EUR	Totali i aktiviteteve	
11.4	Kostot totale operative pa borxhet e këqija			
11.4.1	Totali	EUR	Totali për shërbime	

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
12	Kostot operative - Ujërat e ndotura			
12.1	Grumbullimi			
12.1.1	Kostot e energjisë	EUR	Të gjitha kostot e energjisë që i atribuohen drejtpërdrejt aktivitetit të grumbullimit të ujërave të ndotura por duke përfshijtur energjinë e lëndëve djegëse fosile të përdorura për transport, që përfshihen në kostot e karburantit dhe me sigurimin e energjisë për depot dhe zyrat, të cilat përfshihen në kostot tjera direkte nëse ndërlihen drejtpërdrejt me grumbullimin e ujërave të ndotura ose kostot tjera të biznesit.	
12.1.2	Kostot e karburantit	EUR	Kostot e karburantit të përdorur për transport në lidhje me mbledhjen e ujërave të ndotura, p.sh. automjetet e përdorura për mirëmbajtjen rutinore të rrjetit të ujërave të ndotura.	
12.1.3	Kostot e stafit	EUR	Pagat dhe mëditjet bruto të të gjithë punonjësit të përfshirë në aktivitetin e mbledhjes së ujërave të ndotura, duke përfshirë pagesat që rezultojnë nga skemat e bonuseve dhe pagesat e ndërlidhura me fitimin, kontributet e sigurimeve të punëdhënësve, detyrimet pensionale të pa financuara, pagesat për sëmundje, përfitimet nga sëmundja, sigurimet private shëndetësore, shpërbimet për pensionim, përfitimet në rast vdekjeje gjatë shërbimit, pushimet me pagesë, shpenzimet për udhëtime dhe ato ditore si dhe shpenzimet për trajnime. Kur staf punon në aktivitete të ndryshme, kostot e tyre duhet të ndahen në mes të aktiviteteve, mundësisht duke përdorur fletët e vjueshmërisë ose ndonjë metodë tjetër për regjistrimin direkt të kohës së shpenzuar në aktivitete individuale të shërbimit.	
12.1.4	Materialet dhe artikujt shpenzues	EUR	Të gjitha materialet dhe artikujt shpenzues që nuk përfshihen në shërbimet e kontraktuara apo të marrë me qira. Kjo kategori e kostove përfshin pajisjet (siç janë veglat e vogla dhe veshmbathjet), furnizimet, asfaltin dhe materialet mbushëse të lidhura me mbledhjen e ujërave të ndotura, por përjashton të gjithë zërat e kapitalizuar ose të përfshirë në shpenzimet për rinovimin e infrastrukturës.	
12.1.5	Shërbime të kontraktuara	EUR	Të gjitha pajisjet dhe shërbimet e marra me qira dhe të kontraktuara që ndërlihen me mbledhje e ujërave të ndotura. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerive, pajisjeve për zyre dhe pajisjeve të përgjithshme, si dhe transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë gjithë fuqinë punëtore të kontraktuar dhe këshillimin profesional, siç janë avokatët dhe këshilltarët.	
12.1.6	Mirëmbajtja dhe riparimi	EUR	Kostot e mirëmbajtjes rutinore të infrastrukturës dhe asetëve jo infrastrukturorë të ndërlidhura me mbledhjen e ujërave të ndotura. Përfshihen kostot e mirëmbajtjes së asetëve infrastrukturorë të cilat përfshihen në tarifën e rinovimit të infrastrukturës.	
12.1.7	Kostot tjera direkte	EUR	Çdo kosto tjetër operative që lidhet me mbledhjen e ujërave të ndotura, por duke përfshijtur interesin dhe tatinin. Përfshin kostot që ndërlihen me sigurimin e depove dhe zyrave, si dhe primet e sigurimit për aq sa ato ndërlihen drejtpërdrejt me distribuimin e ujit. Nuk përfshin interesat për kredite.	
12.1.8	Rregullimi nga ARRU	EUR	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që ia mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të kostove operative të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare.	
12.1.9	Kostot totale operative të grumbullimit të ujërave të ndotura	EUR	Totali i aktiviteteve	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
12.2	Trajtimi			
12.2.1	Tarifat për shërbime	EUR	Pagesat ndaj Ministrisë së Mjedisit dhe palëve të treta për shkakimet e ujërave të ndotura në mjedis.	
12.2.2	Kostot kimike	EUR	Kostot për blerjen e kimikateve për trajtimin e ujërave të ndotura në impiantet e trajtimit.	
12.2.3	Kostot e energjisë	EUR	Të gjitha kostot e energjisë që i atribuohen drejtpërdrejt aktivitetit të trajtimit të ujërave të ndotura por duke përjashtuar energjinë e lëndëve djegëse fosile të përdorura për transport, që përfshihen në kostot e karburantit dhe me sigurimin e energjisë për depot dhe zyrat, të cilat përfshihen në kostot tjera direkte nëse ndërliken drejtpërdrejt me trajtimin e ujërave të ndotura ose kostot tjera të biznesit.	
12.2.4	Kostot e karburantit	EUR	Kostot e karburantit të përdorur për transport në lidhje me trajtimin e ujërave të ndotura.	
12.2.5	Kostot e stafit	EUR	Pagat dhe mëditjet bruto të të gjithë punonjësve të përfshirë në aktivitetin e trajtimit të ujërave të ndotura, duke përfshirë pagesat që rezultojnë nga skemat e bonuseve dhe pagesat e nderlidhura me fitimin, kontributet e sigurimeve të punëdhënësve, detyrimet pensionale të pa financuara, pagesat për sëmundje, përfittimet nga sëmundja, sigurimet private shëndetësore, shpërbimet për pensionim, përfittimet në rast vdekjeje gjatë shërbimit, pushimet me pagesë, shpenzimet për udhëtime dhe ato ditore si dhe shpenzimet për trajnime. Kur stafi punon në aktivitete të ndryshme, kostot e tyre duhet të ndahen në mes të aktiviteve, mundësisht duke përdorur fletët e vijueshmërisë ose ndonjë metodë tjetër për regjistrimin direkt të kohës së shpenzuar në aktivitete individuale të shërbimit.	
12.2.6	Materialet dhe artikujt shpenzues	EUR	Të gjitha materialet dhe artikujt shpenzues që nuk përfshihen në shërbimet e kontraktuara apo të marrë me qira. Kjo kategori e kostove përfshin pajisjet (siç janë veglat e vogla dhe veshmbathjet), furnizimet, asfaltin dhe materialet mbushëse të lidhura me trajtimin e ujërave të ndotura, por përjashton të gjithë zërat e kapitalizuar ose të përfshirë në shpenzimet për rinovimin e infrastrukturës.	
12.2.7	Shërbime të kontraktuara	EUR	Të gjitha pajisjet dhe shërbimet e marra me qira dhe të kontraktuara që ndërliken me trajtimin e ujërave të ndotura. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerive, pajisjeve për zyre dhe pajisjeve të përgjithshme, si dhe transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë gjithë luajtjet punëtore të kontraktuar dhe këshillimin profesional, siç janë avokatët dhe këshilltarët.	
12.2.8	Mirëmbajtja dhe riparimi	EUR	Kostot e mirëmbajtjes rutinore të infrastrukturës dhe aseteve jo infrastrukturore të ndërliken me trajtimin e ujërave të ndotura. Përfshihen kostot e mirëmbajtjes së aseteve infrastrukturore të cilat përfshihen në tarifën e rinovimit të infrastrukturës.	
12.2.9	Kostot tjera direkte	EUR	Çdo kosto tjetër operative që lidhet me trajtimin e ujërave të ndotura, por duke përjashtuar interesin dhe tatimin. Përfshin kostot që ndërliken me sigurimin e depove dhe zyrave, si dhe primet e sigurimit për aq sa ato ndërliken drejtpërdrejt me distribucionin e ujit. Nuk përfshin interesat për kreditë.	
12.2.10	Rregullimi nga ARRU	EUR	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që ia mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të kostove operative të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare.	
12.2.11	Kostot totale të trajtimit të ujërave të ndotura	EUR	Totali i aktiviteve	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
12.3	Trajtimi dhe derdhja e llumit			
12.3.1	Tarifat për shërbime		Pagesat ndaj Ministrisë së Mjedisit dhe palëve të treta për pranimin e llumit të ujërave të ndotura.	
12.3.2	Kostot kimike	EUR	Kostot për blerjen e kimikateve për trajtimin e llumi të ujërave të ndotura në impiantet e trajtimit.	
12.3.3	Kostot e energjisë	EUR	Të gjitha kostot e energjisë që i atribuohen drejtpërdrejt aktivitetit të trajtimit dhe derdhjes së llumit të ujërave të ndotura por duke përfshuar energjinë e lëndëve djegëse fosile të përdorura për transport, që përfshihen në kostot e karburantit dhe me sigurimin e energjisë për depot dhe zyrat, të cilat përfshihen në kostot tjera direkte nëse ndërliken drejtpërdrejt me trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura ose kostot tjera të biznesit.	
12.3.4	Kostot e karburantit	EUR	Kostot e karburantit të përdorur për transport në lidhje me trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura.	
12.3.5	Kostot e stafit	EUR	Pagat dhe mëditjet bruto të të gjithë punonjësve të përfshirë në aktivitetin e trajtimit dhe derdhjes së llumit të ujërave të ndotura, duke përfshirë pagesat që rezultojnë nga skemat e bonuseve dhe pagesat e ndërliçura me fitimin, kontributet e sigurimeve të punëdhënësve, detyrimet pensionale të pa financuara, pagesat për sëmundje, përfitimet nga sëmundja, sigurimet private shëndetësore, shpërbimet për pensionim, përfitimet në rast vdekjeje gjatë shërbimit, pushimet me pagesë, shpenzimet për udhëtime dhe ato ditore si dhe shpenzimet për trajtime. Kur stafi punon në aktivitete të ndryshme, kostot e tyre duhet të ndahen në mes të aktiviteteve, mundësisht duke përdorur fletët e vijueshmërisë ose ndonjë metodë tjetër për regjistrimin direkt të kohës së shpenzuar në aktivitete individuale të shërbimit.	
12.3.6	Materiallet dhe artikujt shpenzues	EUR	Të gjitha materiallet dhe artikujt shpenzues që nuk përfshihen në shërbimet e kontraktuara apo të marrë me qira. Kjo kategori e kostove përfshin pajisjet (siç janë veglat e vogla dhe veshmbathjet), furnizimet, asfaltin dhe materialet mbushëse të lidhura me trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura, por përjashton të gjithë zërat e kapitalizuar ose të përfshirë në shpenzimet për rinovimin e infrastrukturës.	
12.3.7	Shërbime të kontraktuara	EUR	Të gjitha pajisjet dhe shërbimet e marra me qira dhe të kontraktuara që ndërliken me trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerive, pajisjeve për zyre dhe pajisjeve të përgjithshme, si dhe transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë gjithë fuqinë punëtore të kontraktuar dhe këshillimin profesional, siç janë avokatët dhe këshilltarët.	
12.3.8	Mirëmbajtja dhe riparimi	EUR	Kostot e mirëmbajtjes rutinore të infrastrukturës dhe aseteve jo infrastrukturorë të ndërliçura me trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura. Përfshihen kostot e mirëmbajtjes së aseteve infrastrukturorë të cilat përfshihen në tarifën e rinovimit të infrastrukturës.	
12.3.9	Kostot tjera direkte	EUR	Çdo kosto tjetër operative që lidhet me trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura, por duke përjashtuar interesin dhe tatimin. Përfshin kostot që ndërliken me sigurimin e depove dhe zyrave, si dhe primet e sigurimit për aq sa ato ndërliken drejtpërdrejt me distribuimin e ujit. Nuk përfshin interesat për kreditë.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
12.3.10	Rregullimi nga ARRU	EUR	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që la mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të kostove operative të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare.	
12.3.11	Kostot totale të trajtimit dhe derdhjes së llumit	EUR	Totali i aktiviteteve	
12.4	Aktivitetet afariste			
12.4.1	Tarifa për shërbime në bazë të ARRU-së, MMPH-së, SHUKOS-it, Odës Ekonomike, etj.	EUR	Të gjitha tarifat, abonimet dhe ngarkesat e tjera që ndërlihen me ARRU-në, MMPH-në, SHUKOS-in, Odën Ekonomike, etj.	
12.4.2	Kostot e energjisë	EUR	Të gjitha kostot e energjisë të ndara për ujërat e ndotura nuk zbatohen për mbledhjen e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin dhe derdhjen e llumit. Kjo përfshin energjinë për ndriçimin dhe ngrohjen e zyrave, depove, punëtorive etj. Kur objektet ndahen mes shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, kostot duhet të ndahen mes tyre.	
12.4.3	Kostot e karburantit	EUR	Të gjitha kostot e karburantit të ndara për ujërat e ndotura nuk zbatohen për mbledhjen e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin dhe derdhjen e llumit. Kjo përfshin energjinë për ndriçimin dhe ngrohjen e zyrave, depove, punëtorive etj. Kur objektet ndahen mes shërbimeve të ujit dhe ujërave të ndotura, kostot duhet të ndahen mes tyre.	
12.4.4	Kostot e stafit	EUR	Pagat dhe mëditjet bruto të të gjithë punonjësve që nuk ndërlihen drejtpërdrejt me aktivitetet e mbledhjes së ujërave të ndotura, trajtimit të ujërave të ndotura dhe trajtimit dhe derdhjes së llumit të ujërave të ndotura, duke përfshirë pagesat që rezultojnë nga skemat e bonuseve dhe pagesat e ndërlihdura me fitimin, kontributet e sigurimeve të punëdhënësve, detyrimet pensionale të pa financuara, pagesat për sëmundje, përfitimet nga sëmundja, sigurimet private shëndetësore, shpërbimet për pensionim, përfitimet në rast vdekjeje gjatë shërbimit, pushimet me pagesë, shpenzimet për udhëtime dhe ato ditore si dhe shpenzimet për trajnime. Kur stafi punon në aktivitetet e ndryshme, kostot e tyre duhet të ndahen në mes të aktiviteteve, mundësisht duke përdorur fletët e vijueshmërisë ose ndonjë metodë tjetër për regjistrimin direkt të kohës së shpenzuar në aktivitetet individuale të shërbimit.	
12.4.5	Materialet dhe artikujt shpenzues	EUR	Të gjitha materialet dhe artikujt shpenzues që nuk përfshihen në shërbimet e kontraktuara apo të marrë me qira dhe që nuk janë të lidhura drejtpërdrejt me mbledhjen e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura. Kjo kategori e kostove përfshin pajisjet (siç janë kompjuterët dhe pajisjet përkatëse, materialet për zyre, mobiliet për zyre, etj.).	
12.4.6	Shërbime të kontraktuara	EUR	Të gjitha pajisjet dhe shërbimet e marra me qira dhe të kontraktuara që nuk ndërlihen drejtpërdrejt me mbledhjen e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura. Shërbimet me qira përfshijnë marrjen me qira të makinerive, pajisjeve për zyre dhe pajisjeve të përgjithshme, si dhe transportin. Shërbimet e kontraktuara përfshijnë gjithë fuqinë punëtore të kontraktuar dhe këshillimin profesional, siç janë avokatët dhe këshilltarët.	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
12.4.7	Mirëmbajtja dhe riparimi	EUR	Kostot e mirëmbajtjes rutinore të aseteve jo infrastrukturore që nuk ndërlidhen drejtpërdrejt me mbledhjen e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura.	
12.4.8	Kostot tjera indirekte	EUR	Çdo kosto tjetër operative që nuk ndërlidhet drejtpërdrejt me mbledhjen e ujërave të ndotura, trajtimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin dhe derdhjen e llumit të ujërave të ndotura. Nuk përfshin interesat për kreditë.	
12.4.9	Rregullimi nga ARRU	EUR	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që ia mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të kostove operative të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare.	
12.4.10	Kostot totale të aktiviteve afariste	EUR	Totali i aktiviteve	
12.5	Kostot totale operative pa borxhet e këqija			
12.5.1	Totali	EUR	Totali për shërbime	

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
14	<p>Plani i menaxhimit të aseteve - ujë</p> <p>Skema duhet të plotësohet nga KRU</p>	<p>Viti i vënies në funksion, EUR, % sipas aktivitetit dhe % sipas burimit të financimit, prova mbështetëse</p>	<p>Kjo fletë pune shërben për të planifikuar të gjitha aktivitetet e investimeve kapitale të furnizimit me ujë që janë planifikuar të vihen në funksion gjatë periudhës së kontrollit të çmimeve.</p> <p>Kolona A përmban detajet referuese të KRU-së për investimin.</p> <p>Kolona B përmban një përshkrim të shkurtër të investimit.</p> <p>Kolona C paraqet shpenzimet kapitale të përlogaritura (duke përfshirë kapitalizimin e interesit gjatë ndërtimit) me çmimet e vitit bazë. Kjo vlerë duhet të përputhet me vlerat (pas rregullimit për inflacion) që do të regjistrohen në regjistrin e aseteve të KRU-së sapo të vihen në funksion.</p> <p>Kolona D përmban vitin e pritsshëm të vënies në funksion. Për qëllime të kontabilitetit rregullator, të gjitha asetet që vihen në funksion çdo vit supozohen të vihen në funksion në mes të vitit (me 30 qershor).</p> <p>Nga Kolona E deri në P bëhet ndarja e investimeve kapitale sipas aktiviteteve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Burimet dhe trajtimi i ujit 2. Distribucioni i ujit 3. Aktivitetet afariste <p>Brenda këtyre aktiviteteve bëhet një ndarje sipas qëllimeve të mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Rinovimi i infrastrukturës (nuk zbatohet për aktivitetet afariste) b. Përmirësimi i infrastrukturës (niveli i shërbimit) (nuk zbatohet për aktivitetet afariste) c. Përmirësimi i infrastrukturës (ekullibri ndërmjet furnizimit dhe kërkesës) (nuk zbatohet për aktivitetet afariste) d. Mirëmbajtja kapitale jo infrastruktururore e. Përmirësimi jo infrastrukturor <p>KRU duhet të caktojë një përqindje për secilën kolonë. Kjo mundëson që një aktivitet i vetëm investues të ndahet ndërmjet aktiviteteve dhe qëllimeve të ndryshme. Përqindjet duhet të jenë gjithsej 100%. Nëse nuk janë 100%, qelizat do të shndërrohen në të kuqe, duke treguar një gabim në të dhënat e futura.</p> <p>Nga Kolona S deri në U bëhet ndarja e mënyrës së financimit të investimit përmes</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Rezervat e parave të gatshme të KRU-së (financim i kapitalit) 2. Financim përmes kredisë 3. Grantet <p>KRU duhet të caktojë një përqindje për secilën kolonë. Kjo mundëson që një aktivitet i vetëm investues të ndahet në shumë opsione financimi, p.sh. në rastin e një përzjerjeje të kredive dhe financimit me kapital. Përqindjet duhet të jenë gjithsej 100%. Nëse nuk janë 100%, qelizat do të shndërrohen në të kuqe, duke treguar një gabim në të dhënat e futura.</p>	

Udhëzuesi i Përdoruesit për Modelin e Përcaktimit të Tarifave për periudhën 2026-2028
Qershor 2025

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
			<p>Kolona X është për KRU-në që të citojë dëshmitë në mbështetje të investimit për të konfirmuar nevojën për investim, kostot e vlerësuara si reale dhe për të vërtetuar se investimi ka të ngjarë të realizohet. Këto dëshmi janë të nevojshme për të bindur ARRU-në që investimi duhet të merret parasysh në procesin e përcaktimit të tarifave.</p> <p>Edhe pse kjo skemë është kryesisht për investime të planifikuara, ARRU pranon që duhet të ketë një dispozitë edhe për investimet emergjente të paplanifikuara. KRU-ja duhet të shënojë një shumë të paparashikuar që do të mbulohet përmes tarifave në këtë skemë, mirëpo çdo shumë e papërdorur do të merret në konsideratë në procesin e "rimbursimit", që ua kthen konsumatorëve mjartet për investimet që ata i kanë paguar, por që nuk janë realizuar.</p>	
14a	Plani i menaxhimit të aseteve - rregullimet për ujë nga ARRU			
	Skema duhet të plotësohet nga KRU	Viti i vënies në funksion, EUR, % sipas aktivitetit dhe % sipas burimit të financimit, prova mbështetëse	Vetëm për përdorim nga ARRU. Kjo është dispozita që ia mundëson ARRU-së të bëjë një rregullim të përgjithshëm të aktiviteteve të investimeve kapitale në furnizimin me ujë të paraqitura nga KRU-të për përcaktimet përfundimtare. Fleta e punës parazgjedhëse i referohet paraqitjeve të KRU-së, por mund të ndryshohet nga ARRU nëse vlerëson se informacioni i dhënë nga KRU është i pamjaftueshëm për t'u marrë plotësisht parasysh në përcaktimin e tarifave. E rëndësishme në këtë vlerësim është detajimi dhe cilësia e dëshmiave të ofruara për të mbështetur investimin.	

Ref	Përshkrimi	Njësia	Udhëzuesi	Ref. e UKRR
